



This program is funded
by the European Union



Pjesëmarrja e Institucionit
të AP në Procesin e
Monitorimit të Konventës
CEDAW dhe Raportimit
përpara Komitetit
CEDAW

MANUAL



This programme is funded
by the European Union



United Nations Entity for Gender Equality
and the Empowerment of Women

“Ky dokument është përgatitur në kuadër të projektit “Ngritja e një rrjeti të organizatave jofitimprurëse për një zbatim më të mirë të standardeve ndërkombëtare mbi barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore në Shqipëri”, i zbatuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL), mbështetur financiarisht nga Komisioni Evropian dhe zbatuar me mbështetjen e UN WOMEN. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e autoreve dhe në asnjë rast nuk reflekton apo përfaqëson domosdoshmërisht mendimin apo qëndrimin e UN WOMEN dhe as të Komisioni Evropian.”

Përgatiti manualin:

Av. Iris Aliaj

Dr. Nadia Rusi

Av. Aurela Bozo

Tabela e përmbajtjes

- I. KONVENTA “Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave”, CEDAW
 - I.1 Monitorimi i zbatimit të vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit CEDAW 2016
 - I.2 Shkrimi i raportit hije nga institucioni i Avokatit të Popullit
- II. Konventa e Stambollit
 - II.1 Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të GREVIO’ s për Shqipërinë
 - II.2 Informacion me shkrim/ përgatitja e raportit nga institucioni i Avokatit të Popullit.
- III. Mekanizmi UPR
 - III.1 Monitorimi i zbatimit të Rekomandimeve të UPR mbi barazinë gjinore dhe dhunën kundër grave 2014;
 - III.2 Informacion me shkrim/ përgatitja e raportit nga institucioni i Avokatit të Popullit.
- IV. Roli i institucionit të Avokatit të Popullit në zbatimin e standardeve ndërkombëtare të Konventës CEDAW, rekomandimeve të GREVIO’ s për Shqipërinë dhe UPR.

SHKURTIME

- - Konventa “Mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave”-Konventa CEDAW
- - Grupi i pavarur i ekspertëve që monitoron zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)-GREVIO
- - Konventa e Këshillit të Evropës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje-Konventa e Stambollit;
- - Institucioni i Avokatit të Popullit-institucioni i AP;
- - Komiteti i Konventës së OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas-Komiteti CEDAW;
- - Rishikimi Periodik Universal-UPR;

HYRJE

Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) është një traktat ndërkombëtar i të drejtave të njeriut që ka si qëllim të eliminojë të gjitha format e diskriminimit kundër grave dhe të promovojë të drejta të barabarta midis burrave dhe grave në të gjithë botën. Deri më sot 189 Shtete janë palë të Konventës. Shqipëria është pjesë e kësaj Konventë që nga viti 1994. Rëndësia e CEDAW në mbrojtjen e të drejtave të grave lidhet me detyrimin që kanë Shtetet palë në këtë Konventë për të promovuar, mbrojtur, respektuar dhe përmbushur një gamë të gjerë të drejtash në kuadër të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit të grave si dhe me qëllim për të siguruar sisteme mbrojtëse adekuate për të përmirësuar pozitën e grave në të gjitha fushat e jetës. Dhuna me bazë gjinore është parashikuar nga Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 i Komitetit si një nga pengesat kryesore të arritjes së barazisë reale midis burrave dhe grave si dhe të realizimit efektiv të të drejtave të grave në të gjitha fushat e jetës.

Plotësimi i detyrimeve konventore të Shteteve monitorohet nga Komiteti CEDAW, një grup prej 23 ekspertësh të pavarur të të drejtave të njeriut. Një nga mënyrat e monitorimit të zbatimit të Konventës nga Shtetet është përmes procesit të rishikimit periodik, përmes të cilit Shtetet Palë janë të detyruar të raportojnë tek Komiteti CEDAW çdo 4 vjet, në lidhje me masat që ata kanë marrë për të zbatuar Konventën. Raportimi periodik i Shteteve është një mekanizëm me rëndësi në evidentimin së pari të progresit që ata kanë bërë në lidhje me zbatimin e Konventës dhe së dyti të fushave më problematike që kanë nevojë për ndërhyrje.

Në raportimet e mëparshme të Shqipërisë, institucioni i AP ka luajtur një rol të rëndësishëm në kuadër të zbatimit efektiv të Konventës CEDAW. Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut përbëjnë një shtyllë themelore të sisteme kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe ato shihen si një mekanizëm kyç që kontribuojnë në zbatimin e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut¹. Përmes monitorimit dhe raportimit në lidhje me progresin e bërë nga Shteti Shqiptar në përmbushjen e detyrimeve të Konventës, AP ka ndihmuar në evidentimin e problemeve specifike të zbatimit të Konventës dhe të aktorëve përgjegjës për zgjidhjen e tyre, duke dalë me propozime konkrete për përmirësimin e situatës së të drejtave të grave në Shqipëri. Gjithashtu, raportet e paraqitura nga AP e kanë ndihmuar Komitetin për t'u njohur me situatën reale të grave në Shqipëri dhe nevojat që ato kanë, me qëllim formulimin e rekomandimeve që i përgjigjen këtyre nevojave.

¹ <http://www.ohchr.org/Documents/AboutUs/Evaluation/NHRI.pdf>

Qëllimi i Manualit

Pajjsja e AP me treguesit dhe metodat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Komitetit në fushën e dhunës me bazë gjinore, ka si qëllim rritjen e ndikimit të këtij institucioni në mekanizmat ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të grave, viktima të dhunës gjinore. Gjithashtu, njohja me rregullat procedurale të nevojshme për hartimin e raporteve hije/alternative si dhe ofrimi i praktikave kombëtare dhe ndërkombëtare për këtë qëllim do të ndihmojë institucionin në përgatitjen e raporteve sa më efektive për Komitetin CEDAW.

Gjithashtu, ky manual ka si qëllim të promovojë rritjen e ndërgjegjësimit të AP në fushën e dhunës me bazë gjinore si dhe të inkurajojë forcimin e dialogut efektiv midis AP në Shqipëri dhe mekanizmave institucionale përgjegjës për zbatimin e Konventës si dhe shoqërisë civile. Dialogu do të orientohet nga detyrimet që ka marrë përsipër shteti shqiptar me ratifikimin e Konventës CEDAW, me qëllim eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, përfshirë edhe dhunën me bazë gjinore.

I. KONVENTA CEDAW

Konventa CEDAW është ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr.7767, datë 9.11.1993.

Pse Konventa CEDAW quhet ndryshe konventa e grave?

CEDAW është një traktat ndërkombëtar i të drejtave të Njeriut që ka si qëllim të eliminojë të gjitha format e diskriminimit ndaj grave dhe të promovojë të drejta të barabarta të grave dhe burrave në të gjithë botën. Shtetet palë janë të detyruara të marrin masa legjislative, gjyqësore administrative dhe çdo masë tjetër të nevojshme, për të ndaluar diskriminimin dhe për të promovuar barazinë midis burrave dhe grave. Ndryshe kjo Konventë quhet **Konventa e Grave**.



Cilat janë fushat që mbulon Konventa CEDAW?

| | |
|---|--|
| <p>PJESA I: Kuadri i përgjithshëm substancial i Konventës Diskriminimi (Neni 1) Masat politike të Shteteve (neni 2) Garantimi i të Drejtave dhe lirive themelore të Njeriut (Neni 3) Masat e Veçanta (Neni 4) Paragjykimi dhe Stereotipat gjinore (Neni 5)</p> | <p>PJESA IV: Fushat substanciale të Konventës Ligji (Neni 15) Martesa dhe Jeta familjare (Neni 16) Treguesit e përcaktuar në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore janë shumë të rëndësishëm për të vlerësuar progresin.</p> |
| <p>PJESA II: Fushat substanciale të Konventës Trafikimi dhe Shfrytëzimi i Prostitucionit (Neni 6) Jeta Politike dhe Publike (Neni 7) Përfaqësimi (neni 8) Shtetësia (Neni 9)</p> | <p>Pjesa V: Komiteti CEDAW dhe procedurat e mbrojtjes Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Neni 17) Raportet Kombëtare (Neni 18) Rregullat procedurale (Neni 19) Mbledhjet e Komitetit (Neni 20) Raportet e Komitetit (Neni 21) Roli i Agjencive të Specializuara (Neni 22)</p> |

| | |
|---|--|
| PJESA III: Fushat substanciale të Konventës Arsimi (Neni 10) Punësimi (Neni 11) Shëndeti (neni 12) Përfitimet ekonomike dhe Sociale (Neni 13) Gratë në zonat rurale (Neni 14) | Pjesa VI: Administrimi dhe Interpretimi i Konventës Efekti mbi traktatet e tjera (Neni 23) Zotimi i Shteteve Palë (Neni 24) Administrimi i Konventës (Nenet 25-30) |
|---|--|

Çfarë kuptoni me Rekomandime të Përgjithshme të Komitetit CEDAW

Rekomandimet e Përgjithshme janë deklarata të Komitetit CEDAW në lidhje me si duhet të interpretohen aspekte të ndryshme të konventës dhe synojnë të jenë udhëzues shtesë për të mbështetur qeveritë në zbatimin e konventës. Rekomandimet e Përgjithshme tipikisht përfshijnë një pasqyrë të shqetësimeve në lidhje me të drejtat e grave, një analizë të mënyrës se si konventa zbatohet në lidhje me këto shqetësime, dhe një listë e masave të rekomanduara për tu zbatuar nga qeveritë.

Çfarë kuptoni me Vërejtjet Përmblyëse të Komitetit CEDAW²?

Pasi Komiteti CEDAW rishikon progresin e një shteti palë dhe sfidat me të cilat ai është përballur në zbatimin e Konventës Komiteti nxjerr Vërejtjet Përmblyëse (të quajtura më parë Komentet përmblyëse) të cilat sigurojnë udhëzime specifike në lidhje me si performance mund të përmirësohet në kontekstin kombëtar. Ato njohin hapat e suksesshëm që janë ndërmarrë për të arritur barazinë gjinore dhe identifikojnë masat më kritike që nevojiten të ndërmerren në të ardhmen në zbatim të konventës.

Ato jo vetëm ofrojnë udhëzime autoritare rreth çfarë kërkon konventa në kontekstet kombëtare, por ato gjithashtu janë mjete advokacie që përdoren nga avokatët e barazisë gjinore për të ushtruar presion për ndryshime në vendet e tyre.

Vërejtjet përmblyëse të Komitetit për çdo raport të vendit janë të vlefshme në web e Komitetit nën çdo sesion të Komitetit.

- **Si mund të orientohet stafi i institucionit të AP në procesin e monitorimit nga detyrimet që i burojnë shtetit shqiptar nga Konventa CEDAW?**

Për t'u njohur me detyrimet që ka shteti shqiptar për të përmbushur (të cilat do të bëhen objekt monitorimi nga ana juaj) është e rëndësishme që stafi i institucionit të familjarizohet me dispozitat që përmban Konventa CEDAW, rekomandimet e përgjithshme të Komitetit, Vërejtjet Përmblyëse të Komitetit për shtetin si dhe Rekomandimet e Komitetit brenda VP.³

² <http://asiapacific.unwomen.org/en/focus-areas/cedaw-human-rights/faq#howcedawdifferent>

³ Përmbajtjen e materialeve të mësipërme mund ta konsultoni tek <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/>.

Në fushën e dhunës me bazë gjinore, Institucioni i AP duhet të monitorojnë zbatimin e detyrimeve të shtetit shqiptar që burojnë nga rekomandimi i Përgjithshëm Nr. 35 i Konventës CEDAW, dispozitat substanciale të Konventës që lidhen me dhunën me bazë gjinore (nenet 1,7,10-14) si dhe Rekomandimet/Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit në fushën e dhunës me bazë gjinore.

• **Ku konsiston ndërveprimi i institucionit të Avokatit të Popullit me Komitetin CEDAW?**

Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut kontribuojnë për fuqizimin e grave përmes mandatit të tyre dhe fuqisë unike. Institucionet Kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut luajnë një rol të rëndësishëm në kuadër të zbatimit efektiv të Konventës CEDAW. Ato mund të bëhen pjesë aktive e mekanizmit të Konventës CEDAW përmes ushtrimit të secilës prej kompetencave të mëposhtme:

- Promovojnë zbatimin e Konventës CEDAW, Protokollit të saj Opsional dhe Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW;
- monitoron masat legjislative, gjyqësore, administrative, dhe masat e tjera të miratuara nga shteti shqiptar për t'u dhënë efekt dispozitave të Konventës CEDAW, Protokollit të saj Opsional dhe Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW.
- I japin Komitetit CEDAW informacion të besueshëm në lidhje me situatën e të drejtave të grave në shtetin e tyre, të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit të tij; *Referuar në Rregullin 47, të Rregullave të Procedurave të Komitetit CEDAW, parashikohet se* Informacioni i marrë nga institucioni i AP ndihmon Komitetin të zhvillojë një dialog konstruktiv me shtetin;
- Përgatisin raporte alternative ose hije ose/dhe informacione me gojë në takimet e grupit të punës para sesionit. Këto raporte lidhen me informacionin e marrë mbi zbatimin e disa ose të gjitha dispozitave të Konventës ose temave specifike që fokusohen në boshllëqet e zbatimit të Konventës ose Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW. Ky informacion shërben për përgatitjen e Listës së çështjeve dhe Pyetjeve, e cila përbëhet nga 30 pyetje.
- Përgatisin raporte alternative ose hije ose/dhe informacione për takimet e Komitetit, bëjnë prezantim me gojë gjatë sesionit të Komitetit dhe janë prezentë gjatë shqyrtimit të raportit të shtetit nga Komiteti CEDAW;
- Mund të ofrojnë informacione alternative për Komitetin gjatë takimeve informale të drekës me anëtarët e Komitetit. Këto takime janë mbajtur zakonisht një ditë para shqyrtimit të raportit të shtetit nga Komiteti;
- Mund të paraqesin raporte alternative/hije në kuadrin e procedurës Follow-up, duke dhënë informacion mbi masat e ndërmarra nga shteti në zbatim të rekomandimeve të zgjedhura nga Komiteti CEDAW;
- Mund të paraqesin raporte alternative/hije në lidhje me raportet e veçanta të kërkuara nga Komiteti, sipas nenit 18 (1) (b) të Konventës dhe Rregullave të Procedurës;
- Të paraqesin inpute në lidhje me rekomandimet e përgjithshme të Komitetit

dhe të përdorin këto rekomandime në përpjekjet e tyre advokuese;

- Mund të përdorin Konventën dhe procedurat në kuadrin e Protokollit Opsional për një dialog të vazhdueshëm me qeverinë dhe parlamentin;
- Organizojnë aktivitete që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimin për të drejtat e njeriut.

Për sa më sipër institucioni i AP mund ta shndërrojë Konventën në një instrument për fuqizimin e të drejtave të grave përmes monitorimit, advokacisë dhe lobimit për zbatimin e Konventës, Vërejtjeve Përmbyllëse dhe rekomandimeve të përgjithshme të Komitetit CEDAW.

Pse është e rëndësishme të njoh Deklaratën e Komitetit CEDAW mbi institucionet kombëtare për të Drejtat e Njeriut në 2008? Ku e vë theksin Deklarata?

- Deklarata e vë theksin në marrëdhënien e Komitetit CEDAW me institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut;
- Komiteti konsideron se institucionet kombëtare të të Drejtave të Njeriut luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e zbatimit të Konventës CEDAW në nivel kombëtar, mbrojtjen e të drejtave të grave dhe rritjen e ndërgjegjësimit të publikut në lidhje me këto të drejta;
- Komiteti inkurajon institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut të publikojnë dhe shpërndajnë konventën dhe Protokollin e saj Opsional, Vërejtjet përmbyllëse, rekomandimet e përgjithshme si dhe vendimet dhe pikëpamjet në lidhje me komunikimet individuale dhe hetimet e kryera në kuadrin e Protokollit Opsional;
- Komiteti inkurajon institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut të monitorojnë zbatimin nga shteti palë të Konventës CEDAW dhe të Protokollit të saj Opsional;
- institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut mund të paraqesin komente dhe sugjerime në lidhje me raportet e shtetit në çdo mënyrë që e shohin të përshtatshme;

Çfarë pret Komiteti CEDAW nga institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut?

- Të sigurojnë që puna e tyre në lidhje ndër të tjera me ankesat individuale dhe zhvillimi i rekomandimeve mbi ligjet, politikat dhe aktivitetet e tyre në lidhje me edukimin për të drejtat e njeriut bazohet në parimin e barazisë formale dhe substanciale⁴ mes grave dhe burrave dhe mosdiskriminimit;
- Të sigurojnë që gratë kanë akses lehtësisht në të gjitha shërbimet për mbrojtjen e të drejtave të tyre;
- Të sigurojnë që përbërja e anëtarëve të stafit të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut është e balancuar nga pikëpamja gjinore në të gjitha nivelet;

⁴ Në raportin "Mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri", 2016 institucioni i AP ka ofruar analizë jo vetëm mbi situatën ligjore por edhe atë faktike. Kështu është analizuar situatë ligjore dhe faktike në lidhje me të drejtat pronësore të grave, çështje të grave dhe strehimit, aksesin e grave në sistemin e drejtësisë dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Reflektim

Reflektoni nëse institucioni juaj i përmbush këto pritshmëri të Komitetit CEDAW që përmban Deklarata.

Sa puna e institucionit të Avokatit të Popullit është bazuar në barazinë substanciale⁵?

A mund të mbështesin institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut gra të cilave ju janë shkelur të drejtat që garanton Konventa CEDAW?

Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut mund të ofrojnë mbështetje për viktimat të cilave ju janë cënuar të drejtat e njeriut që mbulon konventa të paraqesin ankime individuale para komitetit, si dhe të paraqesin informacion të besueshëm në lidhje me mandatin e Komitetit për të kryer një hetim.

A ka krijuar një eksperiencë stafi i institucionit të AP në përgatitjen e raporteve hije për Komitetin CEDAW?

Po, stafi i institucionit të AP ka përgatitur dhe paraqitur para Komitetit CEDAW për sesionin e 64 të këtij Komiteti raportin hije, “Zbatimi i Konventës CEDAW në Shqipëri”. Ky raport është raport hije i raportit të katërt periodik kombëtar mbi zbatimin e kësaj Konvente, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.806, datë 26.11.2014.

Çfarë vendi zënë shqetësimet e grave nga grupet e marginalizuara në raportin hije të institucionit të AP?

Sfidat e grupeve në nevojë zënë një vend të rëndësishëm në raportin e institucionit të AP për Komitetin CEDAW. Kështu në raportin hije të institucionit për sesionin e 64 të Komitetit CEDAW janë prezantuar disa shqetësime të grupeve të grave të moshuara, grave romë dhe egjiptiane, grave me aftësi të kufizuara, grave në institucionet penitenciare, grave dhe vajzave të ngujuara, grave emigrante, etj.

I.(a)MONITORIMI I DETYRIMEVE

- A inkurajon Komiteti CEDAW kontributin e Institucioneve Kombëtare për Të Drejtat e Njeriut në monitorimin dhe raportimin në lidhje me zbatimin nga shteti shqiptar të detyrimeve që i burojnë nga Konventa CEDAW?

Komiteti CEDAW ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me institucionet kombëtare mbi të drejtat e njeriut të miratuar në Deklaratën e tij mbi institucionet kombëtare për të Drejtat e Njeriut në 2008. (goo.gl/96eYm7) Komiteti inkurajon këto institucione të paraqesin informacion specifik mbi çështje që lidhet me zbatimin e Konventës nga Shtetet Palë, çështje të përcaktuara për tu shqyrtuar në sesion.

5 CEDAW ka një vështrim tre dimensional të barazisë së quajtur barazi substanciale. Në vend të konsiderimit të barazisë vetëm në terma formale dhe ligjore thjesht duke qenë gender neutral, CEDAW kërkon që impakti dhe efekti i tyre actual gjithashtu të konsiderohet. Modeli substantive i barazisë kërkon pra përdorimin e kushteve aktuale të jetës së grave më shumë se sa fjalët e përdorura në ligje, si një masë e vërtetë nëse barazia është arritur. Shteti duhet të bëjë më shumë se sa vetëm të sigurohet se nuk ka ligje që diskriminojnë drejtëpërdrejtë gratë. Ai duhet të marrë çdo masë të nevojshme për tu siguruar se gratë aktualisht janë të barabarta në jetët e tyre. <http://asiapacific.unwomen.org/en/focus-areas/cedaw-human-rights/fag#howcedawdifferent>
Raporti i institucionit të AP për sesionin e 64 të Komitetit CEDAW është orientuar fort nga analiza të situatës faktike në lidhje me fushat substanciale të konventës;

Monitorimi i përmbushjes së detyrimeve që burojnë nga Konventa CEDAW është një nga aspektet kyç të përgjegjësive të AP në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe gjithashtu shërben si bazë për rekomandimet, propozimet apo raportet që prodhon AP. Mbrojtja e të drejtave të grave dhe barazia gjinore duhet të mbahen në konsideratë nga AP në të gjitha fazat e procesit të monitorimit, që nga planifikimi dhe mbledhja e të dhënave deri tek analiza dhe hartimi i raportit të monitorimit. Të dhënat ku mund të bazohet AP në lidhje me monitorimin e çështjeve më problematike që shqetësojnë të drejtat e grave mund të evidentohen nga ankesat që ka shqyrtuar AP, hetimet e iniciuara prej tij kryesisht, vizitat e AP në institucione të ndryshme. AP monitoron proceset juridike, legjislativë dhe gjyqësore për të evidentuar çështjet më problematike që shqetësojnë të drejtat e grave në mënyrë që të ndihmojë në përmirësimin e gjendjes së tyre përmes rekomandimeve konkrete. Gjatë veprimtarisë së tij është e rëndësishme që AP të mbledhë të dhëna të ndara sipas seksit në lidhje me ankesat që ai ka shqyrtuar si edhe në lidhje me rezultatet e tyre. Gjithashtu mbi bazën e ankesave të shqyrtuara është me interes që AP të mbledhë të dhëna të ndara mbi baza seksi referuar viktimave dhunës, dhunuesve, lloji i shkeljes së kryer etj. Këto të dhëna si do ta trajtojmë në vijim do të përbëjnë bazën e raporteve hije/alternative të përgatitur nga AP në drejtim të Komitetit CEDAW.

Monitorimi i Konventës CEDAW dhe Rekomandimeve të Komitetit CEDAW

- **Pse është e rëndësishme që institucioni i AP të monitorojë zbatimin e Konventës CEDAW dhe rekomandimet e Komitetit në fushën e dhunës me bazë gjinore?**

Zbatimi i detyrimeve të parashikuara në Konventë apo zbatimi i rekomandimeve të Komitetit është detyrë e shtetit shqiptar. Institucioni i AP mund të luajë një rol të rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes për shtetin në përmbushjen efektive të detyrimeve konventore. Monitorimi i zbatimit të detyrimeve të parashikuara në Konventën CEDAW në lidhje me dhunën me bazë gjinore e ndihmon institucionin që të njihen nga afër me situatën reale të grave viktime të dhunës dhe faktorët që kanë çuar në rritjen e përmasave të dhunës me bazë gjinore në Shqipëri, me qëllim që të propozojë masa për përmirësimin e situatës së tyre. Pjesëmarrja e tyre në procesin monitorues dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me OJF-të e ndihmon gjithashtu institucionin e AP të paraqesë raporte sa më të plota përpara Komitetit CEDAW gjatë sesioneve të raportimeve.

Roli i institucionit të AP në procesin e monitorimit në fushën e dhunës me bazë gjinore mund të evidentohet në lidhje me :

- Monitorimin e zbatimit nga shteti shqiptar të detyrimeve që parashikon Konventa CEDAW në lidhje me diskriminimin e grave dhe Rekomandimi i Përgjithshëm nr. 35 i Komitetit;
- Monitorimin e përmbushjes së Rekomandimeve të Komitetit CEDAW për shtetin shqiptar pas rishikimit, në fushën e dhunës me bazë gjinore.

Për të arritur këto qëllime është e rëndësishme për institucionin e AP që të krijojë mjetet e duhura për monitorimin e zbatimit të Konventës të cilat përqendrohen kryesisht në mbledhjen dhe analizën e të dhënave në fushën e dhunës me bazë gjinore. Konventa në vetvete dhe Rekomandimi i përgjithshëm nr.35 i Komitetit janë dy mjete të rëndësishme ku institucioni i AP mund të referohet gjatë procesit të monitorimit me qëllim që t'i kërkojnë qeverisë së shtetit shqiptar marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e të drejtave të grave në këtë fushë. Gjithashtu përmes mekanizmave monitorues, institucioni i AP jo vetëm mund të nxisë në mënyrë të vazhdueshme shtetin shqiptar për zbatimin efektiv të detyrimeve që parashikon Konventa, por edhe të ndihmojnë në përmbushjen e tyre duke i ofruar autoriteteve shtetërore përgjegjëse ekspertizën e tyre në mbrojtjen e të drejtave të grave dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore. Kryerja me sukses e procesit të monitorimit i hap rrugën institucionit të AP për t'iu drejtuar Komitetit CEDAW me raporte hije/alternative me qëllim sjelljen në vëmendjen e Komitetit të rezultateve të dala nga procesi i monitorimit dhe propozimin e zgjidhjeve për përmirësimin e situatës.

Materiali në vazhdim do të ofrojë njohuri për institucionin e AP në lidhje me:

- Rekomandimet e Komitetit CEDAW në fushën e dhunës me bazë gjinore,
- Treguesit që mund të përdorë institucioni i AP për të matur zbatueshmërinë e rekomandimeve të Komitetit nga shteti shqiptar,
- Burimet nga të cilat institucioni i AP mund të marrë informacion për matjen e tregueseve
- Metodrat që ato mund të përdorin për të marrë informacion në lidhje me përmbushjen ose jo të rekomandimeve të Komitetit nga shteti.

Cilat janë fazat e monitorimit?

Procesi i monitorimit të Konventës CEDAW nga OJF-të mund të ndahet në dy faza:

- Faza e parë: Monitorimi i zbatimit të neneve të Konventës dhe Rekomandimeve të Përgjithshme të Komitetit në fusha specifike.
- Faza e dytë: Monitorimi i zbatimit të Rekomandimeve të Komitetit CEDAW/VP pas sesionit të rishikimit.

Cilat janë disa nga treguesit për matjen e progresit të kryer nga shteti shqiptar në disa nga fushat substanciale të Konventës CEDAW, referuar në situatën e raportuar në 20166?

Sugjerohet që si baseline të shërbejë raporti i fundit i shtetit shqiptar dhe për përcaktimin e treguesve është shumë i rëndësishëm edhe konsultimi me Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit CEDAW.

6 Lista e treguesëve nuk është shteruese. Treguesit e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore shërbejnë gjithashtu si një pikë referimi e një rëndësie të veçantë.

| Diskriminimi (Neni 1) | Baseline | Tregues |
|--|---|---|
| Garantimi i të Drejtave dhe lirive themelore të Njeriut (Neni 3) | Shih Raportin e katërt Shtetëror mbi zbatimin e Konventës CEDAW paraqitur para Komitetit CEDAW; | Treguesit në lidhje me këtë nen duhet të orientohen nga arritjet de facto si në lidhje me kuadrin ligjor dhe politik ashtu edhe në lidhje me zbatimin e këtij kuadri. |
| Masat e Veçanta (Neni 4) | *kuota për përfaqësimin e të dy gjinive në Kodin Zgjedhor (2012), Policinë e Shtetit, Forcat e Armatosura; * mbështetja ekonomike për gratë sipërmarrëse; | *masa të reja në fushat ku gratë janë më pak të përfaqësuara ose në disavantazh; *vlerësim i efekteve të masave të veçanta në arritjen e barazisë gjinore; |
| Paragjykimi dhe Stereotipat gjinore (Neni 5) | *Steriotipet dhe praktikrat e dëmshme mbeten mbizotëruese. Praktika të tilla të dëmshme janë martesat e fëmijëve, zgjedhja e bashkëshortit nga familja dhe pagesa e një çmimi për martesën ose paja. Ripërhapja e konceptit të kanunit dhe zakoneve që tolerojnë vrasjen e grave në emër të të ashtuquajturit “nder”. | *A ka një strategji për rritjen e ndërgjegjësimit? *Nr i autorëve të ndjekur penalisht për vrasje dhe krime të tjera në emër të nderit; Nr i autorëve të dënuar penalisht për vrasje dhe krime të tjera në emër të nderit; |
| Trafikimi dhe Shfrytëzimi i Prostitucionit (Neni 6) | Shqipëria vazhdon të mbetet një vend burimi dhe destinacioni për trafikimin e grave dhe vajzave, në veçanti kjo e lidhur me turizmin në zonat bregdetare. | *Nr i autorëve në hetim, në ndjekje [penale dhe të dënuar për veprën penale të trafikimit të qenieve njerëzore; *Nr i zyrtarëve të përfshirë në veprat penale të trafikimit të qenieve njerëzore; * Nr i viktimave të trafikimit të përballura me përgjegjësi penale; * Nr i viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore të cilave u është ofruar mbështetja e nevojshme përmes programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve dhe dhënies së lejeve të qëndrimit të përkohshme; |

| Diskriminimi (Neni 1) | Baseline | Tregues |
|---|--|--|
| | | <p>*Nr i njësive të lëvizshme të menaxhuara nga grupe të shoqërisë civile, me qëllim identifikimin e viktimave të trafikimit;</p> <p>*Buxheti për njësitë e lëvizshme;</p> <p>*Rritja në % e fondeve shtetërore për qendrat shtetërore për shërbime mjekësore, psikologjike dhe riintegruese për viktimat;</p> <p>Rritja në % e fondeve shtetërore për qendrat e menaxhuara nga OJQ-të, në mënyrë që viktimave të trafikimit t'u sigurohen shërbime mjekësore dhe psikologjike dhe mundësi për tu ri-integruar në shoqëri;</p> |
| <p>Jeta Politike dhe Publike (Neni 7)</p> | <p>*Janë marrë masa legjislative për rritjen e pjesëmarrjes së grave në jetën politike dhe publike;</p> <p>*Është rritur numri i grave në këto fusha. Megjithatë, nuk janë arritur ende kuotat ligjore.</p> <p>*Gratë që u përkasin grupeve në disavanazh dhe të marginalizuara si gratë e komunitetit rom dhe egjiptian dhe gratë me aftësi të kufizuara vazhdojnë të hasin pengesa për pjesëmarrje në jetën politike dhe publike, përfshirë edhe për të ushtruar të drejtën e votës.</p> | <p>*Zbatimi i kuotave ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor dhe Ligjin për Barazinë Gjinore;</p> <p>*numri i sanksioneve ndaj partive politike;</p> <p>* rezultate të monitorimit të masave të veçanta të përkohshme në lidhje me pjesëmarrjen e grave në organet vendim-marrëse në nivelin qendror dhe lokal, si në sektorin publik ashtu edhe atë privat;</p> <p>*Rritja në % e grave që u përkasin komunitetit rom dhe egjiptian dhe gratë me aftësi të kufizuara në jetën politike dhe publike;</p> <p>*kufizime ose pengesat fizike, për të mundësuar këto gra të ushtrorjnë të drejtën e</p> |

| Diskriminimi (Neni 1) | Baseline | Tregues |
|-----------------------|--|---|
| | | pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike, duke përfshirë edhe të drejtën për të votuar; |
| Arsimi (neni 10) | <p>*Numri i vajzave të regjistruara në shkollë vazhdon të jetë më i vogël se i djemve;</p> <p>*Numri i vajzave që braktisin shkollën, në veçanti nga grupet minoritare, në nivelin e dytë arsimor, vazhdon të jetë në mënyrë disproporcionale i lartë. *Mundësi të kufizuara për arsimim për vajzat rome dhe egjiptiane dhe vajzat me aftësi të kufizuara, si dhe fëmijët në zonat e thella dhe rurale, si pasojë e infrastrukturës së dobët të shkollave dhe mungesës së mësuesve.</p> <p>*Diferencimi gjinor dhe përqendrimi i grave që studiojnë në universitet në fusha studimore tradicionalisht të dominuar nga gratë.</p> | <p>*Sa është ulur në % numri i vajzave që braktisin shkollën dhe në veçanti atyre nga komuniteti rom dhe egjiptian?;</p> <p>*Sa është rritur ndjekja e arsimit të detyrueshëm nga djemtë dhe vajzat me aftësi të kufizuara si dhe atyre që jetojnë në zona të thella dhe rurale?</p> <p>*Në sa shkolla është përmirësuar infrastruktura, fondet në mbështetje të përmirësimit;</p> <p>*Numri i trajnimeve të organizuara me mësues në lidhje me reduktimin e braktisjes së shkollës?</p> <p>*Rritja në % e grave dhe vajzave që zgjedhin fusha studimi jo tradicionale;</p> |
| Punësimi (neni 11) | <p>*Shqetësim përqendrimi i grave në tregun informal të punës, pa mbrojtje të përshtatshme shoqërore dhe të kushteve të punës;</p> <p>*Mungesa e të dhënave mbi numrin e grave në ekonominë informale.</p> <p>*Diferencat gjinore në paga mbeten shumë të mëdha, në veçanti në sektorin privat.</p> <p>*Paga minimale është jashtëzakonisht e ulët;</p> <p>*Akses i kufizuar i grave që u përkasin komuniteteve minoritare etnike dhe gjuhësore dhe atyre me aftësi të kufizuara në tregun formal të punës.</p> | <p>* të dhëna statistikore që mbulojnë të gjitha fushat, duke përfshirë edhe sektorin e ekonomisë informale, ku janë përqendruar gratë;</p> <p>* Të dhëna, numri i ankesave në lidhje me mos garantimin e sigurimeve shoqërore dhe të drejtave të punës për gratë që punojnë në sektorin joformal;</p> <p>* të dhëna ose/dhe ankesa në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëmarrësve në sektorët e tekstileve dhe industrisë së këpucëve;</p> <p>*Nr i ankesave në lidhje me shkeljen e parimit pagë e barabartë për punë me vlerë të barabartë;</p> |

| Diskriminimi (Neni 1) | Baseline | Tregues |
|------------------------------------|--|--|
| | | <p>* Masa të veçanta të përkohshme që kanë sjellë akses të barabartë në tregun formal të punës për gratë që u përkasin minoriteteve gjuhësore dhe etnike dhe janë me aftësi të kufizuara;</p> |
| Shëndeti (neni 12) | <p>*Përdorimi i ndërprerjes së shtatëzarisë si metodë kontraceptive;</p> <p>* Gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të largëta dhe gratë e komunitetit rom dhe egjiptian vazhdojnë të kenë akses të kufizuar në shërbimin parësor shëndetësor si dhe në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe shpesh nuk kanë informacion mbi shërbimet;</p> <p>* Planifikim i ulët buxhetor për sektorin e shëndetësisë dhe kontroll i pamjaftueshëm i shërbimeve spitalore;</p> <p>*Rritja e numrit të rasteve të transmetimit të HIV/AIDS nga nënat të fëmijët;</p> | <p>*Numri i fushatave për promovimin e metodave moderne për të parandaluar shtatëzani të padëshiruara;</p> <p>*Të dhëna mbi rritjen e aksesit në shërbimin parësor shëndetësor si dhe në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues për gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të largëta dhe gratë e komunitetit rom dhe egjiptian;</p> <p>*Numri i kurrikulave shkollore në të cilat është përfshirë edukata mbi shëndetin seksual dhe të drejtat riprodhuese, sipas moshës së përshtatshme;</p> <p>*Të dhëna mbi rritjen e buxhetit për sektorin shëndetësor;</p> <p>*Rezultate të monitorimit të shërbimeve spitalore, duke përfshirë edhe ato që kanë të bëjnë me shëndetin seksual dhe riprodhues;</p> <p>* Numri i masave të marra për të parandaluar transmetimin e virusit HIV/AIDS nga nëna te fëmija nëpërmjet kontrolleve të rregullta, diagnostikimit të hershëm dhe shpërndarjes falas të barnave antiretrovirale;</p> |
| Përfitimet Ekonomike dhe Shoqërore | *Zbatim i kufizuar i politikave dhe masave ligjore të ndërmarrë nga shteti në këtë fushë ⁷ , në veçanti në | *nr i mekanizmave për zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave dhe legjisllacionit mbi ndihmën shoqërore në të 61 |

7 Plani i Veprimit për Gratë Sipërmarrëse, Ndryshimet e viti 2014 të "Ligjit mbi Mbështetjen dhe Shërbimet Sociale", që parashikon që ndihma ekonomike tu paguhet drejtpërdrejtë grave


| Diskriminimi (Neni 1) | Baseline | Tregues |
|---|--|--|
| | <p>nivelin lokal dhe në lidhje me gratë dhe vajzat nga grupet e pafavorizuara dhe të marginalizuara.</p> <p>* Shqetësim zbatimi i papërshtatshëm i praktikës së ALUIZNI-t, sipas të cilës ndërtimet informale regjistrohen në emër të të ashtuquajturit “kryetari i familjes”;</p> | <p>bashkitë e vendit.</p> <p>*Rritja e kapaciteteve të institucioneve në lidhje me shpërndarjen e shërbimeve sociale;</p> <p>*Rritja e kapaciteteve të institucioneve në lidhje me fuqizimin ekonomik të të gjitha grave dhe në veçanti atyre që u përkasin grupeve të pafavorizuara dhe të marginalizuara.</p> <p>* Procedura të thjeshta për legalizimin e ndërtimeve informale;</p> <p>* praktika të unifikuara të ALUIZNI-it në mënyrë që dosjet e aplikimit të përgatiten në bazë të certifikatave familjare;</p> |
| <p>Martesa dhe Jeta familjare (Neni 16)</p> | <p>*Vetëm një përqindje e vogël e grave në Shqipëri kanë në pronësi tokë;</p> <p>*Ligji Nr. 33/2012 që parashikon bashkëpronësi për të dy bashkëshortët për pronësinë e vënë gjatë martesës nuk zbatohet në mënyrë efektive.</p> <p>*Diskriminim i grave në çështjet e trashëgimisë.</p> <p>* Shqetësim martesat e fëmijëve, veçanërisht në komunitetet rome dhe egjiptiane, shpesh edhe e autorizuar me vendim gjykatë si përjashtim i moshës minimale të martesës 18 vjeç.</p> <p>* Shqetësim gratë dhe vajzat e ngujuara, që jetojnë të izoluara për periudha shumë të gjata kohe si rrjedhojë e gjakmarrjes.</p> | <p>*numri i akteve administrative të ZQRPP për ZVRPP me qëllim zbatimin e legjislacionit që garanton bashkëpronësi për të dy bashkëshortët për pronësinë e vënë gjatë martesës;</p> <p>*Rishikimi i legjislacionit në mënyrë që gratë të mos trajtohen në mënyrë të pafavorshme në çështjet që kanë të bëjnë me trashëgiminë.</p> <p>*Ndryshimet ligjore për ndalimin e martesave të fëmijëve;</p> <p>*Nr i fushatave sensibilizuese për fëmijët, prindërit, komunitetin dhe profesionistët;</p> <p>*Numri i masave të marra në mbështetje të grave të ngujuara;</p> |

| Diskriminimi (Neni 1) | Baseline | Tregues |
|-----------------------|---|---------|
| | Këto gra kanë akses mjaft të kufizuar në arsim, shëndetësi, pjesëmarrje të ulët në jetën publike dhe politike dhe e kanë të kufizuar lirinë e lëvizjes. | |

- A ka detyrime për shtetin shqiptar në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore, përfshirë dhunën në familje, që burojnë nga Konventa CEDAW?**

Dhuna ndaj Grave nuk është pjesë e fushave substanciale të mbrojtura nga Konventa CEDAW. Megjithatë, Dhuna ndaj grave është e parashikuar në Rekomandimet e Përgjithshme të mëposhtme të miratuara nga Komiteti i Eliminimit të Diskriminimit ndaj Grave:

- Rekomandim i Përgjithshëm Nr. 12 i Komitetit: Dhuna ndaj Grave (1989)
- Rekomandim i Përgjithshëm Nr. 19 i Komitetit: Dhuna ndaj Grave (1992)
- Rekomandim i Përgjithshëm Nr. 35 i Komitetit: Dhuna me bazë gjinore kundër grave (2017)⁷



Komiteti CEDAW në mënyrë specifike në rekomandimet e mësipërme detyron Shtetet të eliminojnë të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, të cilat drejtohen ndaj grave vetëm sepse ato janë gra ose prekin gratë në mënyrë disproporcionale. Çështje të adresimit të dhunës ndaj grave nga shteti shqiptar kanë zënë një vend të rëndësishëm në Vërejtjet Përmblyëse të Komitetit CEDAW të vitit 2016⁸.

Megjithatë, nëse ju kërkoni të përgatisni një raport hije/alternativ në lidhje me *Dhunën me Bazë Gjinore në Shqipëri*, raporti mund të organizohet në mënyrë të tillë që të përfshijë rekomandimet e Komitetit CEDAW në fushën specifike, por gjithashtu mund

⁷ Përmbytjen e këtyre rekomandimeve mund ta gjeni tek: <http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/index.html>

⁸ Vërejtjet Përmblyëse janë të miratuara nga Komiteti në sesionin e tij të 64 të mbajtur në datat 4-22 Korrik 2016. Përmbytjen e plotë të materialit mund ta konsultoni tek http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/ALB/CO/4&Lang=en

të alternohet edhe me nene të tjera të Konventës që kanë lidhje me dhunën me bazë gjinore. (p.sh. Shëndeti/ Arsimi/ Pronësia / Jeta familjare/Fuqizimi ekonomik).

Referimi në Vërejtjet Përmblylëse më të fundit të Komitetit CEDAW (aktualisht të vitit 2016) dhe Rekomandimet e Përgjithshme është i rëndësishëm.

- **Cilat janë disa nga treguesit që mund të përdoren nga OJF-të në monitorimin e standardeve që burojnë nga CEDAW në lidhje me adresimin e dhunës ndaj grave?**

Një nga mënyrat më efektive të monitorimit të zbatimit të detyrimeve të Konventës është përcaktimi i treguesve për të matur plotësimin e detyrimeve nga ana e shtetit. Është e rëndësishme që treguesit të jenë specifikë, të matshëm, të arritshëm brenda një periudhe të caktuar si edhe të përshtatshëm në lidhje me situatën në të cilën ndodhet shteti nën monitorim. Tabela në vijim ka si qëllim të orientojë institucionin e AP në lidhje me disa tregues që mund të përdoren për monitorimin e plotësimin të detyrimeve ligjore, ekzekutive dhe gjyqësore nga shteti shqiptar në kuadër të Rekomandimit të Përgjithshëm Nr.35 të Komitetit.⁹

| Detyrimet për shtetin: | Çfarë duhet të monitoroni? |
|---|--|
| Në nivel legjislativ shteteve u kërkohet që të miratojnë një kuadër ligjor efektiv që ndalon të gjitha format e dhunës me bazë gjinore kundër grave dhe vajzave duke harmonizuar ligjin e brendshëm me Konventën. | <p>Për të monitoruar këtë detyrim ju mund të mbledhni të dhëna në lidhje me këto çështje:</p> <p>A ofron legjislacioni në fuqi mbrojtje nga dhuna me bazë gjinore?</p> <p>Në se po, për cilat forma të dhunës me bazë gjinore, legjislacioni shqiptar parashikon mbrojtje? A është përkufizimi i diskriminimit sipas ligjit shqiptar në përputhje me parashikimet e Konventës? A e përfshin përkufizimi i diskriminimit dhunën me bazë gjinore?</p> <p>A përmban ligji shqiptar dispozita të ndjeshme nga pikëpamja gjinore?</p> <p>Sa efektive janë ligjet që adresojnë format e dhunës ndaj grave?</p> <p>A janë të parashikuara në ligj sanksionet dhe dëmshpërblimi i grave në rastet e dhunës ndaj tyre?</p> <p>A janë të aksesueshëm nga gratë ligjet që adresojnë dhunën me bazë gjinore dhe a ka të dhëna në lidhje me aksesin e tyre në këto ligje?etj.</p> |

⁹ Committee on the Elimination of Discrimination against Women "General recommendation No. 35 on gender-based violence against women, updating general recommendation No. 19", fq.10-11.

| Detyrimet për shtetin: | Çfarë duhet të monitoroni? |
|---|--|
| <p>Në nivel ekzekutiv shtetet palë janë të detyruara të marrin të gjitha masat e nevojshme për ngritjen e mekanizmave të monitorimit të dhunës me bazë gjinore, për krijimin e shërbimeve të aksesueshme dhe të përballueshme për viktimat e dhunës, për eliminimin e praktikave institucionale që rezultojnë në dhunë me bazë gjinore etj.</p> | <p>Për të monitoruar këtë detyrim ju mund të mbliidhni të dhëna në lidhje me këto çështje:</p> <p>A ka ngritur qeveria shqiptare mekanizma të monitorimit të dhunës me bazë gjinore? A ka planifikuar për këto mekanizma buxhet të mjaftueshëm?</p> <p>A buxhetohet në buxhetin e shtetit adresimi i dhunës me bazë gjinore? Po në nivel lokal?</p> <p>A garanton shteti shqiptar ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës në familje? A ofrohet shërbim ligjor falas për to edhe në nivel lokal?</p> <p>A ka mjaftueshëm strehëza dhe shërbime të tjera mjekësore dhe sociale për të rehabilituar gratë viktime të dhunës? A janë ato të aksesueshme nga grupet vulnerable të grave?</p> <p>A ka shteti programe rehabilitimi për viktimat e dhunës me bazë gjinore?</p> <p>Çfarë masash ka marrë qeveria për të parandaluar ngacmimin seksual?</p> <p>A janë të ngritura linjat e këshillimit për viktimat e dhunës në të gjithë territorin? Si funksionojnë ato? A janë të aksesueshme 24/7? Etj.</p> |
| <p>Në nivel gjyqësor, të gjitha organet gjyqësore janë të detyruara të mos përfshihen në asnjë veprim apo praktikë të diskriminimit ose dhunës me bazë gjinore ndaj grave dhe të zbatojnë në mënyrë rigoroze të gjitha dispozitat e ligjit penal që ndëshkojnë këtë dhunë, duke siguruar që të gjitha procedurat ligjore në rastet që përfshijnë raportimet për dhunë me bazë gjinore kundër grave janë të paanshme, të drejta dhe të pandikuara nga stereotipet gjinore ose interpretimi diskriminues i dispozitave ligjore.</p> | <p>A trajtohen seriozisht ankesat e grave në lidhje me dhunën dhe nëse po a hetohen ato në mënyrë efektive?</p> <p>Çfarë vendimesh janë marrë nga gjykatat në lidhje me dhunën në familje? Sa urdhra mbrojtje dhe urdhra të menjëhershëm Mbrojtje janë lëshuar nga Gjykata, gjatë periudhës objekt monitorimi?</p> <p>Sa efektive kanë qenë UM dhe UMM? Cila është shkalla e zbatimit të tyre? A janë marre masa në rast moszbatimi?</p> <p>A përmbajnë vendimet e gjyqtarëve referime të Konventës CEDAW dhe rekomandimeve të përgjithshme të saj?</p> <p>Si i trajtojnë policia dhe autoritetet gjyqësore gratë që raportojnë dhunën seksuale dhe i drejtohen gjykatës?</p> <p>A janë procedurat e ankimit të thjeshta, të aksesueshme dhe të shpejta për viktimat e dhunës me bazë gjinore? Etj.</p> |

Cilat janë hapat që mund të ndjekë AP në lidhje me monitorimin e detyrimeve të shtetit shqiptar referuar Konventës CEDAW dhe VP të Komitetit CEDAW?

Për monitorimin e zbatueshmërisë së detyrimeve të marra përsipër nga shteti shqiptar në lidhje me ratifikimin e Konventës CEDAW, por edhe të VP të Komitetit CEDAW, AP këshillohet të hartojë një plan pune i cili bazohet në hapat e mëposhtme:

- Identifikimi i indikatorëve të përshtatshëm në lidhje me matjen dhe vlerësimin e përmbushjes së detyrimeve të shtetit të dala nga VP të Komitetit CEDAW në fushën e dhunës me bazë gjinore ose në përgjithësi në lidhje me zbatimin e Konventës CEDAW.
- Përcaktimi i objektivave për çdo tregues në lidhje me plotësimin e detyrimeve. Për secilin prej rekomandimeve të Komitetit, AP gjatë veprimtarisë së tij monitoruese, mund t'i japë përgjigje çështjeve: a) çfarë hapash ka ndërmarrë shteti shqiptar për plotësimin e rekomandimeve tek VP; a ka vendosur shteti objektiva për plotësimin e tyre dhe nëse jo pse. A i ka përmbushur shteti objektivat dhe nëse jo pse?
- Mbledhja e të dhënave gjatë periudhës së monitorimit të cilat është e rëndësishme të ndahen sipas seksit.
- Analizimi i rezultateve, hartimi i rekomandimeve specifike dhe raportimi i gjetjeve të monitorimit.
- **Cilat janë disa nga burimet që mund të shfrytëzohë institucioni i AP për të marrë informacion në lidhje me vlerësimin e treguesve për adresimin e dhunës me bazë gjinore?**

Mbledhja e të dhënave në mënyrë të vazhdueshme dhe të orientuara nga çështjet gjinore është një nga sfidat me të cilat përballet institucioni i AP gjatë procesit të monitorimit të zbatimit të konventës CEDAW dhe hartimit të raporteve hije/alternative.

Megjithatë, ekzistojë disa burime kryesore të informacionit dhe të dhënave që mund të shfrytëzohen në varësi të tregueseve që kërkojnë të matin:

- Të dhëna të institucionit të AP¹⁰ mbështetur në ankesat e paraqitura, çështjet e nisura me iniciativë, raportet vjetore, raportet e veçanta, etj.
- Të dhëna të marra nga dokumentet zyrtare;
- Të dhëna të prodhuara si rezultat i studimeve të kryera nga kërkues të pavarur ose nga universitetet;
- Të dhëna të marra nga organizata ndërkombëtare ose nga OJF ndërkombëtare;

Veprimtaria e vetë institucionit të AP është e një rëndësie të veçantë. Kështu, ngritja dhe funksionimi çdo ditë i një komisioni “ad-hoc”, në rolin e një “zyrë këshillimi”, e cila në varësi të objektit të ankesave bën klasifikimin e tyre, “ankesa brenda juridiksionit dhe kompetencës” për t’u shqyrtuar më tej nga ekspertët sipas të drejtës që mbulojnë, si dhe, në “këshillime dhe orientime” për ankesat që nuk janë objekt i kuadrit ligjor, mbi të cilin funksionon institucioni i Avokatit të Popullit mund të përbëjë gjithashtu një burim informacioni.

10 Kështu Raporti i institucionit të AP, “Mbi zbatimin e Konventës CEDAW në Shqipëri”, 2016, në pjesën që ndalet në problemet me të cilat përballen grupet e marginalizuara si gratë e moshuara, gratë rome, gratë LGBTI, gratë në institucionet penitenciare, gratë dhe vajzat e ngujuara, gratë emigrante është mbështetur në raportet vjetore dhe raportet e veçanta të institucionit të AP, ankesat e paraqitura, etj.

- Gjithashtu, informacioni i marrë nga zyrat rajonale (në Berat, Sarandë, Fier dhe Shkoder, Kukës dhe Pogradec etj) është një burim i rëndësishëm. Zyrat Rajonale u krijojnë qytetarëve, në mënyrë të veçantë grave një akses më të madh dhe zgjidhje më të shpejtë të ankesave të tyre ndaj administratës publike, kryesisht me organet e pushtetit vendor, si dhe shkurtojnë distancën fizike mes qytetarit dhe institucionit, për të aplikuar në marrjen e ankesave. Informacioni i siguruar prej këtyre zyrave është gjithashtu një burim i rëndësishëm.
- Informacioni i mbledhur Përmes pritjes së qytetarëve, veprimtarisë së zyrave rajonale dhe Ditëve të Hapura, marrëdhënies së institucionit me median, komunikimit me publikun përmes faqes zyrtare të ëeb-it dhe mediave sociale, bashkëpunimit me organizatat jofitimprurëse në mbështetje të të drejtave të grave përbën informacion të rëndësishëm në lidhje me zbatimin e neneve të Konventës CEDAW.
- Edhe shqyrtimi i çështjeve me nismën e vet AP mund të sigurojë informacion mbi
- raste në të cilat të drejtat janë shkelur.
- E gjithë veprimtaria e institucionit të AP, paraqitja e rekomandimeve tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen e të drejtave dhe lirive, duke pezulluar aktet ose veprimet e paligjshme deri në shqyrtimin e rekomandimit dhe dhënien e përgjigjes AP, rekomandimet për marrjen e masave tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen, rekomandimet prokurorisë për fillimin e hetimeve ose rifillimin e hetimeve të pushuara ose pezulluara, niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP e orientuar në aspektin gjinor sigurojnë informacion të rëndësishëm mbi zbatimin e neneve të Konventës CEDAW.
- **Edhe Rekomandimet legislative janë pjesë e rëndësishme tek të cilat mund të referohet institucioni i AP kur përgatit raportet për Komitetin CEDAW.**

E drejta e institucionit të AP për rekomandime legislative përfshirë rekomandime për organet që kanë të drejtë ligjvënëse, propozime për ndryshim ose përmirësim të akteve nënligjore drejtuar organeve të administratës dhe vënien në lëvizje të GJK me kërkesë për shfuqizimin e ligjit ose akteve të tjera normative, si në rastet kur përmbajnë dispozita diskriminuese në aspektin gjinor ashtu edhe kur ligji në dukje është neutral por zbatimi tij sjell efekte diskriminuese për gëzimin e të drejtave nga gratë bëhet pjesë e rëndësishme e analizës në raporte. Duke analizuar sa rekomandimet legislative janë përmbushur, institucioni i AP ndan edhe rolin e tij në arritjen e barazisë gjinore.

- **Vënia** në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese nga institucioni i AP për çështje që lidhen me barazinë gjinore dhe dhunën me bazë gjinore mund të bëhet pjesë e analizave në raportin e institucionit të AP.
- **Raportimi në Kuvend dhe Raportet e veçanta mund të sigurojnë informacione më të fundit mbi zbatimin e Konventës CEDAW.**

Raportet vjetore të institucionit të AP ngrenë edhe çështje që lidhen me gëzimin e të drejtave të grave. Përveç këtij raporti institucioni mund të raportojë para Kuvendit me nismën e tij ose me kërkesën me shkrim të Kryetarit të Kuvendit ose të një grupi deputetësh.

Raportet e veçanta të cilat hartohen nga institucioni në rastet kur konsiderohet se një praktikë ose situatë e përgjithshme nuk është në pajtim me standardet kombëtare ose ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë rekomandime me qëllim përmirësimin e situatës së krijuar siguron gjithashtu informacion të rëndësishëm për përgatitjen e raporteve hije ose alternative.

Bashkëpunimi me OJF-të dhe institucionet e tjera.

AP bashkëpunon ngushtë me organizatat joqeveritare, në mënyrë të veçantë organizatat që punojnë në fushën e barazisë gjinore dhe mos diskriminimit gjinor. Rrethi i këtij bashkëpunimi konsiston në: marrjen e mendimeve të tyre për garantimin e të drejtave njerëzore të grave në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, në kryerjen e veprimtarive të përbashkëta me objekt garantimin de fakto të të drejtave të grave, në ofrimin e kandidaturave për komisionerë të AP nga gratë me kontribute të spikatura në shoqërinë civile, në pjesëmarrjen e OJQ-ve të grave në komisionet e vlerësimit të kandidaturave për komisionerë të AP, në bërjen pjesë të Bordit Këshillues të shoqërisë civile për të drejtat e njeriut të OJQ-ve të grave, advokacinë e përbashkët, etj. Shumë nga rekomandimet e këtij institucioni si legjislativë ashtu edhe rekomandime për një zbatim më të mirë të legjislacionit mbështeten në këtë bashkëpunim.

Veprimtaria e këtij institucioni në bashkëpunim me OJF-të, me synim përmirësimin e respektimit të të drejtave të grupeve vulnerabël, duke përfshirë Romët, lesbiket, transgender, personat me aftësi të kufizuara mund të ngrëjë çështje shqetësuese që duhen ngritur para Komitetit CEDAW përmes raporteve hije ose alternative.

Praktika e institucionit referuar në nenet e Konventës CEDAW

Institucioni i AP në çështjet e shqyrtuara mund të referohet në nenet e Konventës CEDAW Protokollin Fakultativ të kësaj Konvente dhe detyrimet që burojnë prej tyre, në vërejtjet përmbyllëse të Komitetit CEDAW të 2003, 2010 dhe 2016, rekomandimet e përgjithshme dhe vendimet e tij, pikëpamjet mbi komunikimet individuale dhe hetimet e kryera në kuadrin e Protokollit Fakultativ. Duke bërë pjesë të raportit alternativ ose shadow përdorimin nga institucioni i AP të këtyre akteve si mjete të rëndësishme, institucioni i AP siguron Komitetin CEDAW se në të gjithë veprimtarinë e tij orientohet nga standardet që burojnë nga kjo konventë.

Informacioni i marrë nga një ekspert në institucion i cili është përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore.

Një ekspert pranë institucionit në lidhje me çështjet gjinore dhe integrimin e tyre në veprimtarinë e institucionit mund të sigurojë informacion shumë të rëndësishëm; Kjo do të mundësonte që raportet hije ose alternative të institucionit të AP para Komitetit CEDAW të fokusohen më shumë në perspektivën gjinore në lidhje me çdo çështje. Në raportet e institucionit mund të ketë referime në ankesat e paraqitura nga gratë si edhe objekti i tyre¹¹.

¹¹ Kështu në Rportin e institucionit të AP për sesionin e 64 të Komitetit CEDAW, "Zbatimi i Konventës CEDAW në Shqipëri", në çështjen e shkeljeve të procedurave ligjore për largimin nga puna, raporti është mbështetur në 233 ankesa të paraqitura para institucionit të AP dhe të trajtuara për periudhën tetor 2013-tetor 2014.

Shfrytëzimi i eksperiencës së krijuar nga institucioni në raportim dhe të dhënat progresive

AP ka paraqitur raport hije para Komitetit CEDAW për procesin e rishikimit në vitin 2016. Ky raport mbi zbatimin e Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW në Shqipëri do të përdoret nga stafi i institucionit si një eksperiencë e krijuar tashmë dhe nga ana tjetër do të orientojë që informacionet dhe të dhënat e mbledhura të mblidhen dhe lexohen në mënyrë progresive nga data e raportimit të fundit.

- Praktika e institucionit në mbështetje të komunikimeve individuale për Komitetin CEDAW. **Nëse në praktikën e institucionit të AP rezultojnë të jenë mbështetur komunikime individuale për Komitetin CEDAW, kjo praktikë mund të reflektohet në raportin hije ose alternative për Komitetin CEDAW.**
- **Promovimi, Publikimi dhe shpërndarja e Konventës CEDAW.**

Aktiviteti i institucionit të AP në lidhje me publikimin dhe shpërndarjen e Konventës dhe Protokollit të saj Fakultativ, vërejtjeve përmbyllëse të Komitetit CEDAW¹², rekomandimeve të përgjithshme dhe vendimeve të tij, pikëpamjeve mbi komunikimet individuale dhe hetimeve të kryera në kuadrin e Protokollit Fakultativ mund të ndahet me Komitetin CEDAW përmes raportimit.

- Rekomandohet që institucioni i AP të forcojë lidhjet me institucionet kërkimore (universitetet) dhe kërkuesit shkencore me qëllim që të mbledhin të dhëna më të plota e të sakta. Gjithashtu institucioni i AP duhet të ushtrojë presion tek qeveria dhe autoritetet lokale për krijimin e një sistemi të plotë të dhënash që përfshin tregues të matshëm si dhe të dhëna të ndara nga pikëpamja gjinore në të gjitha sektorët, si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel lokal. Edhe vetë institucioni i AP kur kryen studime duhet të ndajë të dhënat sipas seksit, origjinës etnike, zonave urbane dhe rurale, moshës, etj.
- Po kështu referimi në të dhënat statistikore zyrtare është mjaft i rëndësishëm dhe lehtëson punën e institucionit të AP gjatë procesit të monitorimit të zbatueshmërisë së Konventës CEDAW nga shteti shqiptar. Këto të dhëna mund të konsultohen sipas treguesve të monitorimit të hartuara prej tyre në lidhje me periudhën gjatë të cilës do të kryhet monitorimi. Megjithatë, vlen për t'u përmendur që të dhënat statistikore zyrtare të shtetit shqiptar në fushën e dhunës me bazë gjinore kanë qenë mjaft të cinguara.
- Edhe dokumentacioni i institucionit të AP mund të rishikohet nëse mund të rriten mundësitë e sigurimit të të dhënave të orientuara nga gjinia.

¹² Referuar Rregullave të Procedurës së Komitetit CEDAW, nr.53, Komiteti pasi merr në konsideratë raportet e shteteve palë, bën komente përmbyllëse mbi raportin me qëllim mbështetjen e palës shtetërore në zbatimin e detyrimeve të tij në kuadrin e Konventës.

Në varësi në llojit të treguesit të përcaktuar për adresim e dhunës me bazë gjinore, institucioni i AP mund të hartojë fillimisht një listë të burimeve që mund t'iu shërbejë për t'i dhënë përgjigje pyetjeve të mësipërme ose listës së pyetjeve objekt monitorimi.

Kështu për shembull: nëse doni të monitoroni miratimin e ligjeve që adresojnë dhunën me bazë gjinore, si burim mund të përdorni gazetatat zyrtare, website të parlamentit/ Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtës Sociale, etj.

Nëse doni të monitoroni përputhjen e ligjit të brendshëm me Konventën CEDAW, si burim do t'iu shërbejë Ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Konventa CEDAW.

Nëse doni të monitoroni kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore në çështjet që gjykohen në lidhje me dhunën ndaj grave, përqindjen e rasteve të zgjidhura, sanksionet e dhëna në raste të tilla, si burime mund t'iu shërbejnë statistikatat zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, raporte dhe statistika të gjykatave, raporte dhe publikime të organizatave jo qeveritare që monitorojnë gjykatat në përgjithësi dhe zbatimin e vendimeve gjyqësore në rastet e dhunës ndaj grave në veçanti, raporte të OSBE-së në lidhje me monitorimin e gjyqësorit, etj.

- **Çfarë metodash mund të përdoren nga institucioni i AP për monitorimin e zbatimit të Konventës nga ana e shtetit?**

Me qëllim për të lehtësuar punën e institucionit të AP në procesin e monitorimit, ky manual hedh dritë edhe mbi disa prej metodave që mund të përdoren për të mbledhur të dhënat ose informacionin e nevojshëm për to.

Kështu, përveç intervistave të ankuesve, dhe informacionit të siguruar nga vetë institucioni, AP mund të përdorë gjithashtu mundësinë e organizimit të takimeve me fokus grupe, hartimin e pyetësorëve si dhe kërkesat drejtuar autoriteteve publike kompetente për marrjen e informacionit.


Në rastin e kërkesave për të marrë informacion nga autoritetet publike, ju mund të kërkontë informacion nga çdo organ ligjor, ekzekutiv, administrativ, gjyqësor që e disponon ose që ka autoritetin për ta ofruar. Kërkesa për të marrë informacion duhet të bazohet në Ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Në çdo rast autoriteti publik ka detyrimin për t'iu pajisur me informacionin që ju kërkontë brenda 10 ditëve pune nga marrja e kërkesës nga autoriteti publik, me përjashtim të rasteve kur ligji i posaçëm të cilit ju mund t'i referohemi përcakton një afat ndryshe¹³

13 Për më tepër në lidhje me afatet për marrjen e informacionin nga autoriteti publik sipas kërkesës së bërë nga ju shih Nenin 15 të Ligjit 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

2. PROCESI I RISHIKIMIT TË KONVENTËS NGA KOMITETI CEDAW DHE PARAQITJA E RAPORTEVE HIJE/ALTERNATIVE.

- Si është i organizuar procesi i rishikimit dhe cilat janë hapësirat e pjesëmarrjes së institucionit të AP në këtë proces?

PROCESI I RISHIKIMIT¹⁴



14 Global Alliance Against Traffic in Women (2011) "A toolkit for reporting to CEDAW on trafficking in women and exploitation of migrant women workers", fq 14.

Pas nxjerrjes së Vërejtjeve Përmbyllëse të Komitetit CEDAW, institucioni i Avokatit të Popullit mund të masë sa çështjet e ngritura prej institucionit në raportet me shkrim ose me gojë janë bërë pjesë e këtyre Vërejtjeve Përmbyllëse.

Çfarë parashikon Deklarata e Komitetit CEDAW në lidhje me rolin e institucioneve kombëtare për të Drejtat e Njeriut të paraqesin informacione me shkrim?

Komiteti CEDAW mirëpret paraqitjen nga institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut të informacioneve me shkrim në lidhje me raportet e shteteve palë që janë para grupit të para sesionit të Komitetit. Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut mundet gjithashtu ta ndjekin fizikisht dhe të paraqesin informacion me gojë në takimet e përcaktuara për ta në grupet e punës para sesionit dhe sesionet e Komitetit.

• Pse është e rëndësishme për institucionin e AP që të përfshihet në procesin e rishikimit?

Objektivat kryesore të pjesëmarrjes së institucionit të AP në procesin e rishikimit janë:

- Rrit ndërgjegjësimin e Komitetit në lidhje me çështjet kyç dhe shqetësimet që lidhen me zbatimin e Konventës nga Shtetet.
- Lobon me Komitetin për të ngritur çështjet kyç dhe pyetjet specifike me shtetin gjatë dialogut interaktiv
- Influencon Vërejtjet Përmbyllëse dhe Rekomandimet duke promovuar marrjen e masave dhe strategjive kundër dhunës ndaj grave.

Ndërkohë që Komiteti merr informacion nga Shteti në lidhje me zbatimin e Konventës, është po aq e rëndësishme edhe informacioni që institucioni i AP mund t'i japë Komitetit. Kjo, pasi ky institucion mund të vlerësojë në mënyrë kritike se si masat e marra nga shteti mund të ndikojnë drejtpërdrejt në parandalimin dhe eliminimin e dhunës me bazë gjinore. Stafit i institucionit të AP i japin gjithashtu Komitetit informacione shtesë në lidhje me situatën e grave në vendin objekt rishikimi, të cilat mund të mos jenë dhënë apo njohur nga shtetet. Komiteti vlerëson rolin e institucioneve kombëtare për mbrojtjen e të

drejtave të njeriut si mjaft të rëndësishëm në procesin e rishikimit dhe kërkon prej tyre t'i drejtojnë atij çështjet më shqetësuese në lidhje me dhunën me bazë gjinore në vend. Gjithashtu pjesëmarrja në procesin e rishikimit i jep mundësi institucionit të AP të zgjerojë të kuptuarit e Komitetit në lidhje me dhunën me bazë gjinore, të promovojnë marrjen e masave efektive kundër dhunës ndaj grave dhe si rezultat të sigurojnë që procesi i rishikimit të garantojë efektivisht përmirësimin e të drejtave të grave dhe situatën e grave të dhunuara në vend.

Gjithashtu AP mund të inkurajojë qeverinë shqiptare në plotësimin e detyrimeve të saj për raportimin përpara Komitetit CEDAW. Pikërisht, duke dialoguar në mënyrë të vazhdueshme me autoritetet shtetërore, AP mund të ndikojë në forcimin e vullnetit shtetëror për të përmbushur detyrimet e tij konventore. Edhe në rastet kur AP nuk harton një raport të vetin të pavarur nga ai i shtetit, AP mund të ndihmojë strukturat përgjegjëse shtetërore duke iu ofruar asistencën e nevojshme në shkrimin e raportit të shtetit, nisur nga monitorimet dhe hetimet që ai vetë ka kryer në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që ka marrë përsipër shteti ose përmbushjen e rekomandimeve të Komitetit CEDAW. AP mund gjithashtu të lehtësojë trajnime të nëpunësve civilë me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre në shkrimin e raporteve për Komitetin CEDAW.

- **Çfarë është sesioni i para-rishikimit dhe cili është roli i institucionit të AP në këtë proces?**

Sesioni i para-rishikimit mbahet disa muaj përpara mbajtjes së sesionit zyrtar të rishikimit të shtetit. Në këtë fazë grupi i punës i Komitetit takohet për të rishikuar raportin e dërguar nga shteti dhe çdo informacion shtesë që i është dërguar Komitetit përpara sesionit. Gjatë këtij takimi, grupi i punës identifikon boshllëqet në informacion dhe i dërgon qeverisë një listë të pyetjeve dhe çështjeve për t'iu përgjigjur përpara rishikimit formal. Kjo listë mund të përfshijë fushat të cilat Shteti nuk i ka raportuar ose pyetje në lidhje me masat që janë marrë. Lista e çështjeve është mjaft e rëndësishme në rrugën e procesit të rishikimit pasi shërben si një tregues në lidhje me fushat më problematike që shqetësojnë gratë.¹⁵

këshillohet që informacioni që do t'i jepni Komitetit në këtë fazë duhet të përmbajë:

- Çështjet më kritike/shqetësuese me të cilat po përballen gratë (përfshirë gratë e dhunuara) në Shtetin tuaj;
- Çfarë mungon në raportin e Qeverisë;
- Për cilat çështje do të donit ju që Komiteti të pyeste Qeverinë .

Faza e para-rishikimit përcakton drejtimin, tonet dhe çështjet për dialog midis Komitetit dhe qeverisë gjatë sesionit të rishikimit. Për këtë arsye, rekomandohet që institucioni i AP dhe OJF-të të jenë sa më aktive gjatë gjithë kësaj faze. AP kontribuon përmes një raporti hije ose një informacioni të shkurtër me shkrim, ku të nënvizohen çështjet kyç që Komiteti duhet të marrë në konsideratë gjatë përgatitjes së Listës së çështjeve. Përfaqësues të institucionit të AP mund të bëjnë gjithashtu një prezantim me gojë të këtyre çështjeve tek anëtarët e Komitetit në fillim të Punës në Grupin përpara Sesionit.

Lista e çështjeve dhe pyetjeve nuk duhet të jetë shumë e gjatë ose e komplikuar. Ju duhet të jeni sa më konkretë, për të ndihmuar grupin e punës për të kuptuar se çfarë po ndodh në vendin tuaj. Nëse ju e keni hartuar ndërkohë një raport hije për Komitetin, atëherë mund të dërgoni një draft të tij bashkë me një listë me çështjet më me rëndësi dhe boshllëqet në raportin e shtetit. Anëtarë të Komitetit i kanë vlerësuar në disa raste më të nevojshme listat e çështjeve se sa vetë raportet shteruese mbi këto çështje.

- **Çfarë duhet të ketë parasysh institucioni i AP, nëse mund të marrë pjesë gjatë sesioneve të rishikimit?**

Institucioni i AP mund të marrë pjesë në sesionet e rishikimit përmes:

1. Prezantimeve me gojë: Komiteti dëgjon informacionin direkt nga institucioni i AP, në lidhje me Shtetet subjekt rishikimi, në formën e prezantimeve me gojë. Institucioni i AP ka në dispozicion 10 minuta për t'i adresuar Komitetit informacionin e nevojshëm. Kjo është një mundësi e mirë që të nënvizojë dhe të rrisë vëmendjen e Komitetit mbi çështjet më problematike siç i ka detajuar në raportet hije, të identifikojë pyetjet specifike që Komiteti CEDAW mund të ngrejë gjatë rishikimit të raportit të shtetit si dhe të propozojë rekomandime/zgjidhje të problemeve në lidhje me zbatimin e Konventës.

¹⁵ Global Alliance Against Traffic in Women (2011) "A TOOLKIT FOR REPORTING TO CEDAW ON TRAFFICKING IN WOMEN AND EXPLOITATION OF MIGRANT WOMEN WORKERS", fq 17.

Kujdes! Koha e prezantimit është e limituar. Për këtë arsye ju duhet të mendoni paraprakisht për natyrën dhe përmbajtjen e prezantimit që të jeni sa më efektivë. Këshillohet të jini preciz dhe rigoroz në identifikimin e çështjeve shqetësuese në lidhje me dhunën ndaj grave në vend dhe ofroni eksperiencën tuaj mbi evidentimin e praktikave që do të çojnë në përmirësim të të drejtave të grave.

Me qëllim që prezantimi i institucionit të AP përpara Komitetit të jetë sa më efektiv brenda kohës në dispozicion, sugjerohet të merren parasysh disa nga rekomandimet e mëposhtme:

- Diskutoni mbi çështjet kritike të raportit alternativ/hije;
- Identifikoni pyetje që Komiteti mund të ngrejë gjatë shqyrtimit të raportit të shtetit;
- Prezantoni çdo informacion të ri që nga paraqitja e raportit me shkrim ose nga paraqitja e raportit ose informacionit për grupin e punës para sesionit;
- Propozoni rekomandime/zgjidhje për problemet e hasura në zbatim të Konventës;

2. Takime informale (Informal lunchtime briefing session): Ju mund të organizoni dhe të ftoni anëtarët e Komitetit në një sesion të shkurtër informimi. Kjo është një mundësi për JU që të informoni anëtarët e Komitetit mbi çështjet urgjente/ kyç dhe për Komitetin për të sqaruar çështje të ndryshme që lidhen me informacionin e dhënë përmes raporteve të shtetit ose raporteve të tjera të paraqitura nga institucioni i AP dhe OJF-të. Edhe pse anëtarët e Komitetit nuk janë të detyruar të marrin pjesë, shumica merr pjesë në këto takime, të paktën për një kohë të shkurtër. Përmes këtyre takimeve, ju keni mundësi gjithashtu të loboni me anëtarët e Komitetit për të ngritur çështje të veçanta ose për t'i drejtuar pyetje specifike shtetit gjatë dialogut ndëraktiv. Kjo mund të bëhet me gojë ose përmes informacioneve me shkrim.

Në identifikimin e çështjeve që do të adresoni në takimet informale shihni edhe njëherë ato që keni ngritur si më shqetësuese në Raportin Hije/Alternativ si dhe Listën e çështjeve të identifikuar më parë nga Komiteti. Sigurohuni të jeni të përgatitur me informacionin më të përditësuar, jo vetëm me çështjet e ngritura nga Komiteti por edhe me përgjigjet e Shtetit, të cilat publikohen në web e Komitetit CEDAW. Organizoni prezantimin tuaj që të mos zgjasë më shumë se 10 minuta. Gjithashtu kini parasysh që interpretimi përgjithësisht nuk është i lejuar në këto takime informale. Nëse nuk i përgjigjeni dot të gjitha pyetjeve të ngritura nga anëtarët e Komitetit, sigurojini ata që do t'i dërgoni informacion në formë të shkruar mbi këto pyetje. Këto takime janë private dhe vetëm anëtarët e Komitetit kanë mundësi që të bëjnë pyetje dhe të kërkojnë sqarime nga ju. Me qëllim që takimet informale me anëtarët e Komitetit të jenë të suksesshme rekomandohet të merren parasysh këshillat e mëposhtme:

- Identifikoni një moderator dhe një ose dy folës nga grupi juaj;
- Kujto që anëtarët e Komitetit dëshirojnë ta përdorin këtë mundësi për pyetje dhe sqarime;

- Sigurohuni që keni listën emërore të anëtarëve të Komitetit;
3. Takime një nga një (One to one): Ndërkohë që Anëtarët e Komitetit janë në sesion në pjesën më të madhe të ditës, takimet një nga një mund të organizohen përpara, pas dhe ndonjëherë edhe gjatë sesionit. Këto takime ju ofrojnë mundësinë për të rritur ndërgjegjësimin e anëtarëve të Komitetit në lidhje me çështjet kritike që kanë nevojë për t'u adresuar brenda vendit. Takimet duhet të organizohen nga institucioni i AP dhe të përfshijnë Raportuesin e Shtetit dhe anëtarët e Komitetit që kanë interes në çështjet e ngritura¹⁶. (p.sh. anëtarët e Komitetit që kanë interes në të drejtat e grave të dhunuara, eliminimin e dhunës me bazë gjinie, çështje të shërbimit ligjor falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, etj.).

Për t'u mbajtur mend: Edhe në këtë rast sigurohuni që keni një listë të anëtarëve të Komitetit për t'u njohur me emrat e tyre. Ju nuk keni nevojë për lehtësues për të takuar anëtarët e Komitetit. Përpara ose pas sesioneve mund të prezantoheni me ta dhe t'i pyesni nëse kanë kohë të takohen me ju. Nëse nuk kanë kohë të lirë në moment, mund t'i ftoni për drekë ose çaj në çdo moment tjetër të përshtatshëm për ta. Ndërkohë pas rishikimit të raportit të shtetit përgatitni një dokument të shkruar në lidhje me çështjet që ju do të donit të përfshiheshin në Vërejtjet Përmblyëse dhe dorëzoheni tek anëtari i Komitetit që do të jetë Raportues i Shtetit.

- **Cilat janë format e raporteve që institucioni i AP mund t'i dërgojë Komitetit CEDAW?**

Institucioni i AP mund t'i dërgojë Komitetit CEDAW një raport hije (hije raport) ose alternative, përmes të cilave informon Komitetin në lidhje me mënyrën se si shteti që monitorohet ka plotësuar detyrimet që përmban Konventa dhe Rekomandimet përkatëse.

Ndryshimi midis një raporti Hije dhe raportit Alternativ është se ***Raporti Hije hartohet nga institucioni duke patur akses dhe lexuar paraprakisht raportin e shtetit mbi zbatimin e Konventës***. Përmes raportit hije ju analizoni në mënyrë kritike raportin që Shteti i ka paraqitur Komitetit dhe bëni komente në lidhje me të. Kur institucioni i AP e shkruan raportin e saj, kur raporti qeveritar nuk është përgatitur (p.sh sepse qeveria nuk e ka shkruar atë ose e shkruan me vonesë) ky raport quhet Raport Alternativ.

Burimi: International Women's Rights Action Watch Asia Pacific (IWRAP Asia Pacific), 2010, ***Participation in the cedaw reporting process: process and guidelines for writing a shadow report, fq. 11***

Në hartimin e raporteve duhet të mbahet parasysh që t'i jepen Komitetit të dhëna sa më të plota dhe të besueshme në lidhje me çështjet që po trajton.

Për shembull: Nëse ju po përgatitni një raport hije/alternative në lidhje me Dhunën me bazë Gjinore merrni në konsideratë të përfshini në raportin tuaj:

¹⁶ Global Alliance Against Traffic in Women (2011) "A TOOLKIT FOR REPORTING TO CEDAW ON TRAFFICKING IN WOMEN AND EXPLOITATION OF MIGRANT WOMEN WORKERS", fq 26.

- Të dhëna statistikore në lidhje me situatën e dhunës ndaj gruas në vend.
- Informacion në lidhje me situatën reale të grave të dhunuara në vend;
- Informacion në lidhje me impaktin dhe progresin e bërë nga shteti mbi zbatimin e Konventës dhe Rekomandimeve të Komitetit, në lidhje me Dhunën me bazë gjinore;
- Shkelje të të drejtave të grave dhe sidomos të dhëna në lidhje me evidentimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore;
- Boshllëqe në ligj dhe politika shtetërore dhe rekomandime mbi plotësimin e tyre;
- Informacion rreth sfidave për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të grave viktime të dhunës me bazë gjinore¹⁷.
- **Çfarë hapash duhet të ndërmerret institucioni i AP për të përgatitur një raport Hije/Alternativ?**

Me qëllim që raporti i përgatitur të ndikojë sa më shumë në rekomandimet që Komiteti CEDAW do t'u shpërndajë shteteve sugjerohet që të merren parasysh hapat e mëposhtme:

1. Identifikoni prioritetet përmes një mbështetje të koordinuar.

Në përgatitjen tuaj për t'u përfshirë në procesin e raportimit tek Komiteti CEDAW, organizoni takime me sa më shumë organizata që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e të drejtave të grave, me qëllim që të identifikoni çështjet kryesore/ urgjente që ndikojnë në mos gëzimin/ mos ushtrimin nga ana e grave të të drejtave në mënyrë të barabartë me meshkujt. Në çdo rast, konsultimi në procesin e raportimit me OJF, koalicione ose rrjet organizatash mund ta bëjë raportin tuaj më efektiv, duke qenë se ai është shprehje e zërit të një numri të madh grash. Kjo formë e raportimit sugjerohet sidomos, nëse institucioni i AP ka si qëllim të hartojë një raport hije/alternativ me karakter të përgjithshëm, për secilin Nen të Konventës. Në këtë rast OJF-të që operojnë në fusha të ndryshme mund të japin inputet e tyre në përgatitjen e raportit sipas Neneve të Konventës.

Po kështu rekomandohet që për të paraqitur raporte sa më të plota, raporti i përgatitur të përfshijë edhe çështje cross cutting si dhuna me bazë gjinore dhe gratë me aftësi të kufizuara, LGBTI, rome, gratë egjiptiane, gratë e moshuara, etj.

Në lidhje me strukturën e raportit, nëse raporti i institucionit të AP do të ketë strukturën e raportit të shtetit kjo do të ndihmonte Komitetin për të krahasuar këtë informacion me informacionin e përfshirë në raportin e shtetit dhe informacionin me shkrim të paraqitur nga OJF-të, koalicionet apo rrjetet e organizatave.

2. Mblidhni dhe analizoni informacionin/ të dhënat alternative

Sapo të keni rënë dakord në lidhje me çështjet shqetësuese, mblidhni të dhëna në lidhje me to dhe analizoni situatën konkrete të grave në fushën objekt raportit. Konventa

¹⁷ International Women's Rights Action Watch Asia Pacific (IWRAP Asia Pacific), 2010, **Participation in the CEDAW reporting process: process and guidelines for writing a shadow/alternative report, fq. 2**

CEDAW, VP në rishikimin e fundit dhe rekomandimet e përgjithshme të Komitetit duhet të përdoren nga ju si mjeti kryesor për vlerësimin e hapave dhe masave që ka marrë shteti, në mënyrë progresive. Të dhënat që do të mblidhni do t'iu shërbejnë për të hartuar rekomandimet, në lidhje me masat që duhet të merren për të eliminuar diskriminimin e grave në nivel kombëtar.

Për të hartuar raporte të suksesshme mund të konsideroni sugjerimet e mëposhtme:

1. Përpiquni të familjarizoheni sa më mirë me Konventën CEDAW. **Lexoni paraprakisht Vërejtjet Përmbyllëse** që Komiteti CEDAW ka hartuar për Shtetin në monitorimin e fundit. Lexoni në lidhje me **parimet kryesore të Konventës CEDAW, Rekomandimet e Përgjithshme** të Komitetit CEDAW dhe Protokollin Opsional të saj.
2. Mblidhni dokumente që përmbajnë të dhëna në lidhje me statusin e grave në vend (ligje, vendime gjykatash, statistika). Përpiquni të mblidhni informacion në lidhje me suksesin ose dështimin e shtetit në përmbushjen e detyrimeve të vendosura nga Konventa. **Nëse shteti ka bërë hapa pozitive mos i harroni pa përmendur ato!** Nëse ka dispozita ligjore me natyrë diskriminuese i sillni ato në raport.
3. Mblidhni informacion në lidhje me **eficencën e organeve shtetërore** që kanë si detyrim promovimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të grave në veçanti.
4. Me interes do të ishte edhe puna e kryer nga Kuvendi i Shqipërisë, i cili duhet të luajë një rol të rëndësishëm në zbatimin e Konventës CEDAW;

Burimi (International Women's Rights Action Watch Asia Pacific (IWRAP Asia Pacific), fq. 3 2010)

Për t'u marrë në konsideratë!

Nëse do të hartoni një raport hije mbi dhunën në bazë gjinore në sesionin e ardhshëm të CEDAW (2020) për Shqipërinë, merrni në Konsideratë të përfshini informacion në lidhje me masat që ka marrë shteti për të zbatuar vërejtjet përmbyllëse dhe rekomandimet e Komitetit pas raportimit të katërt periodik (2016).

Disa nga çështjet kyç të evidentuara nga Komiteti të cilat ju duhet t'i monitoroni:

- Përqindja e ulët e raportimit të dhunës me bazë gjininë;
- Aksesit i kufizuar i grave në shërbimet e ndihmës ligjore (fokusi tek gratë rurale);
- Ngritja e MR në të gjithë vendin dhe forcimi i MR ekzistuese; (në nivel lokal);
- Numër i pamjaftueshëm i strehëzave për gratë që janë viktime të dhunës në familje dhe kriteret shtrënguese për pranimin në to;
- Mungesa e shërbimeve mjekësore dhe psikologjike në qendrat për rehabilitimin e grave të dhunuara;
- Dështim i shtetit në zbatimin e Urdhrave Mbrojtës dhe urdhrave të menjëhershëm të Mbrojtjes¹⁸.

18 Committee on the Elimination of Discrimination against Women (2016) "Concluding observations on the fourth periodic report of Albania", fq.6, në formatin online tek http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/ALB/CO/4&LangqEn

Rekomandimet që Komiteti i ka dhënë Shtetit në VP, ku ju sugjerohet të bazoheni lidhen me:

- Masa për të inkurajuar gratë të raportojnë dhunën me bazë gjinore duke ofruar ndihmë ligjore falas dhe ngritur linjat 24-orëshe të telefonit në të gjithë vendin;
- Forcimi i rolit dhe kapacitetit të autoriteteve kompetente për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës;
- Rritja e numrit të strehëzave, rritja e financimit të strehëzave të krijuara nga OJQ-të dhe krijimi i mekanizmave për kontraktimin dhe delegimin e shërbimeve në këto strehëza;
- Forcimi i zbatimit të Vendimeve gjyqësore, në veçanti të vendimeve të lëshimit të urdhrave Mbrojtës/urdhrave të Menjëhershëm Mbrojtës;
- Rritja e kapacitetit të personelit gjyqësor, përfshirë përmbaruesit.¹⁹

Konsultohuni edhe me Rekomandimin e Përgjithshëm Nr. 35: “Dhuna me bazë gjinore kundër grave” (2017).

3. Përgatisni raportin Hije/Alternativ

Pasi të keni përcaktuar çështjet më problematike dhe të keni mbledhur informacionin e nevojshëm në lidhje me to është momenti që të hartoni raportin tuaj për Komitetin CEDAW. Për këtë duhet të ndiqni rregullat procedurale të hartuara nga ky Komitet. Është e rëndësishme për institucionin e AP që të nënvizojnë në fillim të raportit çështjet strukturore që përbëjnë diskriminim ose që kanë dështuar për ta adresuar atë.

Organizimi i raportit²⁰:

Në rastin e një raporti hije/alternative mbi dhunën me bazë gjinore nuk është e nevojshme të merrni në analizë të gjitha nenet e Konventës. Ju duhet të bazoheni tek detyrimet që vendos Rekomandimi 35 i Komitetit CEDAW (REK. 19 i rishikuar) si dhe tek Nenet e tjera të Konventës që mund të lidhen me dhunën ndaj grave (diskriminimi, Arsimi, Shëndeti, jeta familjare, etj.)

1. Mënyra më e mirë për të organizuar raportin tuaj është sipas Neneve të Konventës, duke ndjekur linjën e raporteve qeveritare. Gjatë fazës së dialogut ndëraktiv, Komiteti ngre çështjet dhe pyet shtetin sipas Neneve të konventës. Për këtë arsye, organizimi i raportit në këtë formë i vjen në ndihmë Komitetit për të ngritur çështjet më me interes. Nëse ju po hartoni një raport hije, ai mund të organizohet si një qëndrim i juaji në lidhje me raportin e shtetit me të cilin ju jeni njohur më parë.

Por, gjithashtu ju mund të hartoni një raport Hije duke zgjedhur të jepni informacion **vetëm në lidhje me Nene të caktuara mbi të cilat ju keni ekspertizë.**

19 Committee on the Elimination of Discrimination against Women (2016) “Concluding observations on the fourth periodic report of Albania”, fq.6, në formatin online tek http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW/C/ALB/CO/4&Lang=En

20 Rregullat në lidhje me organizimin e raportit janë bazuar tek “Producing Shadow Reports to the CEDAW Committee: A Procedural Guide” nga International Women’s Rights Action Watch të cilën mund ta konsultoni online tek <http://hrlibrary.umn.edu/iwraw/proceduralguide-08.html>

2. Raporti duhet të shkruhet në mënyrë koncize, të qartë, të saktë dhe objektive. Informacioni që ju do të vendosni në raport duhet të jetë i besueshëm dhe të mbështetet në prova. Në çdo rast, në raport duhet të nënvizohen çështjet më problematike si dhe të përfshihen rekomandime në lidhje me përmirësimin e situatës së grave²¹.

Dokumentet mbështetëse mund të përfshijnë: Statistika, vendime gjyqësore, dëshmi të individëve, transmetime mediatike, dispozita ligjore, vendime qeveritare. Statistikat janë më të nevojshme nëse ndahen sipas moshës, gjinisë, gjendjes martesore etj.

3. Mbani parasysh të identifikoni çështjet më me prioritet në raport. Komiteti CEDAW nuk ka mundësi të fokusohet në të gjitha çështjet. Ju takon ju detyra, të përcaktoni problemet që mund të përfshihen në Listën e çështjeve të Komitetit.

Merrni në konsideratë për shembull: *Rritja e ndërgjegjësimit qytetar mbi nevojën për raportim të dhunës me bazë gjinore; edukimi dhe trajnimi i aktorëve të nevojshëm (policia, nëpunësit shtetërorë, gjyqtarë, prokurorë, përmbarues) në lidhje me Konventën CEDAW, Rekomandimet e Përgjithshme, standardet Ndërkombëtare; forcimi i kapaciteteve mbrojtëse të viktimave të dhunës; statistika të ndara sipas gjinisë; buxheti gjinor dhe krijimi i një zëri të veçantë në buxhet për viktimat e dhunës me bazë gjinore në nivel vendor, etj.*

Identifikoni se cilat janë vështirësitë më të mëdha në kuadër të garantimit të të drejtave të grave dhe bëni rekomandime specifike për të zgjidhur problemet. **Cilët aktorë duhet të përfshihen?** Kush duhet të trajnohet në lidhje me Konventën CEDAW dhe Rekomandimet e Përgjithshme të saj? A ka vështirësi në lidhje me burimet financiare të nevojshme për zbatimin e masave mbrojtëse?

Evidentimi i aktorëve përgjegjës për zgjidhjen e problemeve është shumë i rëndësishëm. Mos lidhja e rekomandimeve me organin përgjegjës mund t'i bëjë jo efektive marrjen parasysh të rekomandimeve nga Komiteti apo edhe nga vetë qeveria shqiptare.

4. Raporti duhet të përmbajë rekomandime konkrete që sugjerojnë veprime specifike. Për këtë lexoni paraprakisht Vërejtjet Përmbyllëse të Komitetit. Duhet të jeni sa më të qartë në hartimin e rekomandimeve.

5. Raporti sugjerohet të përmbajë në pjesën hyrëse të tij një përmbledhje ekzekutive në lidhje me përmbajtjen e raportit. Kjo përmbledhje e ndihmon komitetin për t'u njohur me çështjet kyç që kanë nevojë për ndërhyrje. Informacioni duhet të jetë i shkurtër, i saktë dhe të jetë shkëputur me kujdes nga raporti. Ai duhet të përfshijë çështjet kryesore të raportit hije, të dhënat që mbështesin çështjet kryesore si dhe rekomandimet për qeverinë në lidhje me adresimin e çështjeve kyç.

• Cila mund të jetë struktura e raportit hije të institucionit të AP?

Me qëllim që të ofrojë një pasqyrim të saktë të problemeve më kritike dhe të ofrojë adresimin e tyre përmes rekomandimeve specifike çdo raport hije duhet të përfshijë:

²¹ Midis çështjeve të trajtuara në rekomandimet përmbyllëse dhe raportimit tuaj sugjerohet të ketë një lidhje logjike.

1. Faqja hyrëse që përfshin Titullin/ Emri i institucionit/ Emri i Shtetit Palë/ Tematika nëse është e përcaktuar/ Data e Raportit hije/alternativ;
2. Përmbledhje Ekzekutive;
3. Tabela e Përmbajtjes;
4. Hyrja: Në këtë pjesë institucioni jep informacion në lidhje me përgatitjen e raportit hije/alternativ. Shpjegoni shkurt metodologjinë e përgatitjes së raportit. Në mënyrë të shkurtër përmbledhni (1-2 paragrafë) çështjet më shqetësuese në lidhje me të drejtat e grave. *Nënvizoni veçanërisht: çfarë parashikon Konventa për këto çështje, cilat janë dispozitat ligjore kombëtare që lidhen me çështjet, çfarë roli ka luajtur qeveria dhe çfarë masash ka marrë ose duhet të merrte ajo për të adresuar problemet. Përfshi të dhëna statistikore, grafikë, dëshmi të viktimave të dhunës, etj.*
5. Pjesa kryesore e organizuar sipas Neneve të Konventës. *(Përfshin analizë të problemit sipas neneve; pyetjet kryesore që duhet të merren parasysh nga Komiteti për t'ia adresuar shtetit; rekomandimet e sugjeruara (mund të përfshijnë ndryshime të ligjit, politika, praktika në nivel qendror ose lokal.)*
6. Pjesa përmbyllëse.
7. Shtojca (mund të përfshijë tekste ligjesh, referenca etj).²²

Cili është roli i institucionit të AP në përgatitjen e Vërejtjeve Përmbyllëse dhe Rekomandimeve nga Komiteti CEDAW?

Pas fazës së dialogut ndëraktiv, Raportuesi për Shtetin formulon Vërejtjet Përmbyllëse dhe jep Rekomandimet për Shtetin objekt rishikimi. Këto nënvizojnë aspektet pozitive, çështjet shqetësuese si dhe Rekomandimet e Komitetit në lidhje me mënyrën se si duhet të adresohen nga shteti. Influencimi në Vërejtjet Përmbyllëse dhe rekomandimet është me shumë rëndësi. Komiteti do të monitorojë zbatimin e tyre nga ana e shtetit në sesionet e ardhshme.

Institucioni i AP mund t'i përdorë Vërejtjet Përmbyllëse dhe Rekomandimet për monitorimin progresiv, hartimin e raporteve të tyre dhe për të lobuar e advokuar për zbatimin e tyre në nivel kombëtar. Po kështu, AP mund t'i përdorë Vërejtjet Përmbyllëse për të përcaktuar prioritetet në veprimtarinë e tij të ardhshme. Ato mund të drejtojnë AP duke i dhënë mundësi këtij të fundit të mund të përdorë resurset e veta në mënyrën më të mirë të mundshme për të përmirësuar situatën e të drejtave të njeriut brenda vendit. Gjithashtu AP mund t'i përdorë Vërejtjet përmbyllëse për të konfirmuar masat që ka marrë shteti në lidhje me përmirësimin e të drejtave të njeriut në çështjet që ato reflektojnë si urgjente si edhe të ndihmojë ai vetë në zbatimin e vërejtjeve specifike nga ana e shtetit.

Është e rëndësishme të nënvizohet se që një çështje të përfshihet në Vërejtjet Përmbyllëse ajo duhet të jetë ngritur gjatë dialogut ndëraktiv. Për këtë arsye

²² "International Women's Rights Action Watch "Producing Shadow Reports to the CEDAW Committee: A Procedural Guide të cilën mund ta konsultoni online tek <http://hrlibrary.umn.edu/iwraw/proceduralguide-08.html>

komunikimi i përfaqësuesve të institucionit të AP me Komitetin përpara dialogut ndëraktiv dhe në të gjitha format e shpjeguara më lart është thelbësor, për të siguruar që çështjet kyç janë ngritur përpara Komitetit.

Pas dialogut ndëraktiv, përfaqësuesit e institucionit të AP mund të përpiqen të takojnë Reporterin e Shtetit dhe t'i japë atij një deklaratë mbi atë se çfarë do të dëshironin të shihnin në Vërejtjet Përmbyllëse për shtetin Shqiptar.

I. (b) RAPORTIMI PËR MEKANIZMIN E KONVENTËS CEDAW, KOMITETIN CEDAW

1.9. PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM NJË RAPORT NGA INSTITUCIONI I AVOKATIT TË POPULLIT?

AP si një Institucion i rëndësishëm Kombëtar për të Drejtat e Njeriut mund të luajë një rol të rëndësishëm në procesin e raportimit mbi Konventën CEDAW.

Në përgjithësi, Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut kontribuojnë në përgatitjen e raporteve të Shteteve Palë, duke përfshirë konsultimin dhe komentet në lidhje me raportin zyrtar shtetëror, përgatitjen e një raporti hije/nga një institucion kombëtar i të Drejtave të Njeriut; prezantime me gojë në grupet e punës para sesioneve të Mekanizmave të Konventave, përveç paraqitjes së informacionit me shkrim në shqyrtimin formal të raportit të Shtetit Palë²³.

Komiteti me marrjen e raportit periodik të Shqipërisë cakton datën e shqyrtimit dhe grupet e punës para sesionit punojnë me raportin dhe përgatisin një listë me çështje dhe pyetje²⁴ për Shqipërinë dy sesione para sesionit në të cilin do të shqyrtohet raporti.

Komiteti CEDAW mirëpret informacionin specifik të institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut në lidhje me raportet shtetërore para grupit të punës para-sesionit ose para Komitetit. Një informacion i tillë mund të paraqitet me shkrim para ose në takimin e grupit të punës para-sesionit ose në sesionin përkatës të Komitetit.

Institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut mund gjithashtu të jenë prezent dhe ofrojnë informacion me gojë në takimet e caktuara për ta në grupet e punës para sesionit dhe sesionet e Komitetit. Komiteti do të caktojë kohën e duhur për kontributin e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut në axhendën e përkohshme të takimit të grupit të punës ose sesionit me qëllim që të rrisë vizibilitetin e inputeve nga institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut²⁵.

Raporti i paraqitur nga institucioni i AP do të bënte autoritetet më të përgjegjshëm në zbatimin e detyrimeve që burojnë nga konventa CEDAW, konventë e ratifikuar nga shteti shqiptar.

23 Information Note, National Human Rights Institutions (NHRI)s interaction with the UN Treaty Body System.

24 Rregullat e procedurës së Komitetit CEDAW, nr.4.

25 Statement by the Committee on the Elimination of Discrimination against Women on its relationship with national human rights institutions, Committee on the Elimination of Discrimination against Women, Fortieth session 14 January-1 February 2008

1.10. A është krijuar një praktikë nga institucioni i AP në lidhje me raportimin pranë Komitetit CEDAW?

Po. Institucioni i AP ka paraqitur në sesionin e 64 të Komitetit CEDAW një raport shadow mbi zbatimin nga shteti shqiptar të detyrimeve që burojnë nga Konventa CEDAW. Ky raport i përgatitur nga institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur Udhëzimet e përgatitjes së raporteve nga Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe është paraqitur në Komitetin CEDAW si një raport hije/alternativ.

Raporti përbën një monitorim të përmbushjes së detyrimeve të shtetit shqiptar nga Konventa CEDAW në lidhje me çështjet:

- pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje,
- fuqizimin ekonomik të grave,
- aksesin e grave në sistemin e drejtësisë,
- adresimin e dhunës në familje,
- aksesin e grave në shërbimet sociale.

Gjithashtu, AP ka kontribuar në përgatitjen e raportit të IV periodik të shtetit shqiptar, në mbështetje të nenit 18 të Konventës mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.

1.11. Ku konsiston metodologjia e përgatitjes së raportit të institucionit të AP?

- Raporti i përgatitur nga institucioni i AP duhet të përbëjë një analizë të arritjeve dhe boshllëqeve ligjore dhe faktike;
- Raporti orientohet nga Nenet e Konventës CEDAW, VP e Komitetit CEDAW 2010 dhe Rekomandimet e Përgjithshme të CEDAW;
- Raporti mbështetet në Veprimtarinë e AP (shqyrtimi i ankesave, rekomandimet për zgjidhjen e tyre, çështjet e nisura me iniciativë, rekomandimet legjislative, raportet vjetore dhe të veçanta paraqitur në Kuvendin e RSH-së, kryerja e inspektimeve, bashkëpunimi i ngushtë me OJF-të që punojnë për të drejtat e njeriut);
- Raporti referohet në treguesit e vlerësimit dhe të monitorimit të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave, të përcaktuar me Udhëzim nga MPCSSHB.
- Raporti referohet në të dhënat nga Raportet Kombëtare të shtetit mbi zbatimin e Konventës CEDAW;
- Raporti mund të referohet në takime dhe intervista, me përfaqësues të aktorëve të ndryshëm shtetërorë dhe jo shtetërorë;
- Raporte dhe studime ekzistuese të aktorëve shtetërorë, organizatave të shoqërisë civile, raportet e progresit për Shqipërinë dhe raporte të organizatave të ndryshme ndërkombëtare janë një burim shumë i rëndësishëm në shkrimin e raportit të institucionit të AP.

Informacioni mund të ndahet me gojë dhe/ose me shkrim.

A ka kërkesa Komiteti CEDAW për institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, që dëshirojnë të paraqesin informacione me shkrim në sesion?

Po, institucionet Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut u kërkohet të:

- Identifikojnë emrin e plotë të institucionit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut;
- Tregojnë shtetin me të cilin lidhet informacioni i paraqitur;
- Tregojnë nëse ose jo informacioni me shkrim mund të postohet në websitin e Komitetit CEDAW për qëllim të informimit publik;
- Paraqet informacion me shkrim që nuk kalon 3300 fjalë, në format wordi me email;

Kur dhe ku paraqitet informacioni me shkrim nga institucionet kombëtare për të drejtat e Njeriut?

Materiali me shkrim duhet të merret tre javë para fillimit të sesionit nga Sekretariati i Komitetit. Informacioni me shkrim duhet të dërgohet elektronikisht në format word në adresën e emailit: CEDAW@ohchr.org. Nëse Institucionet Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dëshirojnë të paraqesin informacionin në hard copy, atyre ju kërkohet të dërgojnë 15 kopje të materialit në adresën e mëposhtme:

CEDAW Sekretariat
OHCHR - Palais Wilson
52, rue des Pâquis
CH-1201 Geneva 10
Switzerland

A ndryshon procedura e paraqitjes së materialit me shkrim nga institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut për sesionin e CEDAW nga procedura për grupet e punës para sesionit?

Grupi i punës para sesionit mbledhet në mbledhje të mbyllura dhe përgatit listën e çështjeve për shtetet palë.

Grupi i punës para sesionit përgatit listën e pyetjeve dhe çështjeve për shtetet palë të përcaktuara për tu rishikuar dy sesione më vonë.

Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut që dëshirojnë të paraqesin informacion me shkrim për grupin e punës para sesionit duhet të ndjekin të njëjtën procedurë si edhe për paraqitjen e informacionit me shkrim për sesionin.

Informacioni me shkrim duhet të dërgohet elektronikisht në format word në adresën e emailit: CEDAW@ohchr.org. Nëse Institucionet Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dëshirojnë të paraqesin informacionin në hard copy, atyre ju kërkohet të dërgojnë 15 kopje të materialit në adresën e mëposhtme:

CEDAW Sekretariat
OHCHR - Palais Wilson
52, rue des Pâquis
CH-1201 Geneva 10
Switzerland

1.12. A duhet që raporti shadow i institucionit të AP të analizojë një nga një nenet e Konventës CEDAW?

Raporti jo domosdoshmërisht duhet të ndalet në të gjitha nenet e Konventës CEDAW. Raporti mund të përzgjedhë disa çështje si më shqetësueset. Kështu raporti i paraqitur nga institucioni i AP në sesionin e 64-t të Komitetit CEDAW ka identifikuar si çështje shqetësuese:

- pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimmarrje,
- aksesimi i Grave në sistemin e drejtësisë,
- fuqizimi ekonomik i grave dhe përfitimet ekonomike shoqërore,
- dhuna në familje dhe qeverisja e ndjeshme gjinore;
- Orientimi: Barazia de facto

1.13. Cilat janë hapësirat që përfaqësuesit e institucionit të AP të luajnë rol në sesionet e Komitetit CEDAW?

Disa hapësira janë:

- Organizmi i lunch briefings me anëtarë të Komitetit CEDAW;
- Lobim anëtarëve të Komitetit gjatë sesionit të CEDAW;
- Vëzhgimi i dialogut midis shtetit dhe anëtarëve të Komitetit CEDAW;
- Bërja e rekomandimeve për vërejtjet përmbyllëse. Institucioni i AP mund të përgatisë rekomandime dhe të llojë Komitetin me qëllim përfshirjen e tyre në Vërejtjet përmbyllëse;

1.14. Si matet sukcesi i institucionit në sesionet e Komitetit CEDAW?

Një nga treguesit është sa nga çështjet e ngritura nga institucioni i AP u bënë pjesë e rekomandimeve të Komitetit CEDAW;

1.15. Si përzgjidhen çështjet nga Komiteti CEDAW në kuadrin e procedurës Follow up?

Përzgjedhja e çështjeve bëhet në bazë të kriterit nëse çështjet e zgjedhura për veprim/masa afatshkurtra përbëjnë një pengesë për gëzimin e të drejtave të njeriut nga gratë dhe zbatimin e CEDAW në tërësi;

1.16. Çfarë terminologjie mund të përdorë stafi i institucionit të AP kur përgatit raporte në kuadrin e procedurës së follow up?

Terminologjia që duhet përdorur përfshin termat: Rekomandim i zbatuar, Rekomandim i pazbatuar; Rekomandim pjesërisht i zbatuar dhe Mungese informacioni për të bërë vlerësim;

1.17. Çfarë duhet të ketë parasysh stafi i institucionit të AP kur përgatit raporte për Komitetin CEDAW në kuadrin e procedurës së follow up?

Institucioni i AP mund të paraqesë raporte follow up, të cilat duhet të jenë koncize dhe nuk duhet të kalojnë 3500 fjalë;

Deadlini i sugjeruar për paraqitjen e raportit nga institucioni i AP është një muaj pasi raporti follow up i shtetit është bërë publik.

Raporti dërgohet në word, në sekretariat me email në CEDAW@ohchr.org

4 kopje dërgohen në adresën postare të sekretariatit: Office of the UN High Commissioner for Human Rights, secretariat of the CEDAW, Palais Wilson, 52 rue des Paquis, CH-1201, Geneve, Sëitserland;

- **Çfarë është procedura Follow-up dhe cili është roli i institucionit të AP në këtë procedurë?**

Procedura Follow-up ka si qëllim të asistojë Shtetin në lidhje me zbatimin e Konventës. Komiteti ka miratuar një procedurë follow-up të vërejtjeve të tij përmbyllëse dhe ka përcaktuar metodologjinë, sipas të cilës një shteti palë i kërkohet të paraqesë informacion brenda një ose dy viteve, mbi veprimet e ndërmarra për të zbatuar rekomandimet e përzgjedhura në kuadrin e procedurës follow up. Zakonisht përzgjidhen dy rekomandime.

Përzgjedhja e çështjeve bëhet në bazë të kriterit nëse çështjet e zgjedhura për veprim/masat afatshkurtra përbëjnë një pengesë për gëzimin e plotë dhe efektiv të të drejtave të njeriut nga gratë dhe zbatimin e CEDAW në tërësi;

- **Cilat janë rregullat procedurale që AP duhet të ndjekë në hartimin e raportit follow-up?**

Gjatë procedurës follow-up institucioni i AP mund t'i paraqesë Komitetit CEDAW raporte alternative të cilat nuk duhet të jenë më shumë se 3500 fjalë. Afati i dërgimit të këtyre raporteve është një muaj pasi raporti follow-up i shtetit bëhet publik. Raportet mund të dërgohen në format elektronik (në Word) tek CEDAW@ohchr.org

Për t'u konsideruar: Mbi procedurën follow-up për Shqipërinë (2018)

Komiteti i kërkon Palës Shtetërore që të sigurojë brenda dy vitesh, informacion me shkrim për hapat e ndërmarra në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të përfshira në paragrafët 13 (b) dhe (d) dhe 23 (a) dhe (d) të Vërejtjeve 2016 që konsistojnë në:

- Të marrë masa për forcimin e autoritetit të Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike në Ministrinë e Drejtësisë me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore parësore ose dytësore duke përfshirë këtu edhe ngritjen e klinikave ligjore vendore të specializuara për ofrimin e ndihmës juridike;
- Të ndryshojë barrën e provës në rastet e pretenduara për diskriminim mbi bazë seksi ose me bazë gjinore
- Të marrë masa për të inkurajuar gratë që të raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore, duke ofruar ndihmë juridike falas deri nat rurale dhe të largëta dhe duke vendosur shërbimin telefonik 24-orësh;
- Të forcojë sistemin e zbatimit të vendimeve të gjyqs, në veçanti atyre që kanë të bëjnë me urdhrat e mbrojtjes apo urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve.

Shteti shqiptar duhet të paraqesë raportin në lidhje me 4 çështjet e theksuara më lart në Korrik 2018.

Terminologjia që përdoret mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve follow up nga Shtetet është si vijon:

- “Zbatuar” – në rast se shteti paraqet evidenca të plota të zbatimit të të gjitha rekomandimeve të dhëna nga Komiteti.
- “Zbatuar në thelb”- në rast se Shteti paraqet të dhëna dhe fakte të veprimeve substanciale të marra në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, por që nuk i përgjigjet në mënyrë të plotë përbushjes së rekomandimit.
- “Zbatuar pjesërisht”- Në rast se Shteti ka ndërmarrë disa masa/veprime me qëllim zbatimin e rekomandimeve por ka nevojë për më shumë veprime për t’u përbushur plotësisht detyrimet.
- “Nuk është zbatuar”- Në rast se Shteti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për përbushjen e rekomandimeve të Komitetit.
- “Mungesë informacioni për të bërë vlerësim”.
- “Informacioni ose masat e marra vijnë në kundërshtim me rekomandimin ose nuk e marrin parasysh atë”- në rast se Shteti nuk ndërmerr asnjë masë ose tregon se hedh poshtë rekomandimet e Komitetit.

Burimi: Komiteti CEDAW, Information on the follow-up procedure , 2017 tek http://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/1_Global/INT_CEDAW_FGD_7103_E.pdf

- **Si mund të monitorojmë zbatimin e rekomandimeve follow up të Komitetit CEDAW për Shqipërinë dhe cilat janë disa nga treguesit²⁶ që mund t’i shërbejnë institucionit të AP për të matur zbatueshmërinë e rekomandimeve të Komitetit nga shteti shqiptar gjatë fazës follow-up?**

REKOMANDIM Nr.13 (b): Të marrë masa për forcimin e autoritetit të Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike në Ministrinë e Drejtësisë me qëllim ofrimin e ndihmës ligjore parësore ose dytësore duke përfshirë këtu edhe ngritjen e klinikave ligjore vendore të specializuara për ofrimin e ndihmës juridike;

Në lidhje me marrjen e masave për ofrimin e ndihmës juridike falas, disa nga treguesit që mund të përdoren janë:

- Niveli i përfshirjes në ligjet/aktet nënligjore/strategjitë dhe politikat përkatëse të masave /dispozitave që parashikojnë të drejtën për ndihmë juridike dhe ndihmë juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Ndryshimet ligjore me ligjin nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Burimi i informacionit: Analizë ligjore;

- Numri i rasteve të viktimave të dhunës me bazë gjinore që kanë përfituar ndihmë juridike falas nga KSHNJ gjatë dy viteve të fundit, të ndara sipas formës së dhunës gjinore, qytet/fshat, grupeve të marginalizuara nga vijnë rastet, llojit të ndihmës/ moshës së viktimës/ origjinës etnike.

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar MD, KSHNJ; analiza vjetore të MD,etj;

²⁶ Treguesit dhe burimet e listuara nuk janë shteruese. Ato do të zhvillohen më tej në konsultim me institucionin e AP;

- Numri i klinikave ligjore (të ngritura nga shteti dhe organizatat) që ofrojnë ndihmë ligjore falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, të ndara sipas: a) qytetit, b) llojit të ndihmës juridike të ofruar, c) llojin e ofruesit (avokatët, sektori publik, joqeveritar, Organizatat) të ngritura gjatë dy viteve të fundit.

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar MD; analiza vjetore të dy viteve të fundit të MD; web i UNDP; web i Fondacionit SOROS për info mbi klinikat ligjore në universitete; web i OJF-ve²⁷, media sociale e organizatave të tjera që kanë ngritur klinika ligjore gjatë dy viteve të fundit;

- Të dhëna në lidhje me kapacitetet njerëzore, trajnimet e stafit dhe buxhetin e klinikave ligjore të ngritura;
- Numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës gjinore, që kanë përfituar ndihmë juridike parësore dhe dytësore gjatë dy viteve të fundit nga KSHNJ.
- Të dhëna në lidhje me krijimin e një formulari të standardizuar në lidhje me ndihmën ligjore, krijimin e një databaze në lidhje me statusin e kërkesës së çdo subjekti të interesuar.

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar MD, KSHNJ; analiza vjetore të MD;

- Përqindja e organizatave joqeveritare të grave që marrin fonde shtetërore për ofrimin e ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, në krahasim me numrin e përgjithshëm të OJF që e ofrojnë këtë ndihmë çdo vit.

Burimi i informacionit: raporte të OJF-ve që ofrojnë shërbim ligjor falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, në nivel kombëtar;

REKOMANDIM Nr.23 (a): Të marrë masa për të inkurajuar gratë që të raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore, duke ofruar ndihmë juridike falas deri në zonat rurale dhe të largëta dhe duke vendosur shërbimin telefonik 24-orësh;

Në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e linjave telefonike të këshillimit të viktimave të dhunës me bazë gjinore, disa nga treguesit që mund të përdoren janë:

- Niveli i përputhjes së politikave dhe standardeve të ofruesve të këtij shërbimi të specializuar për viktimat e dhunës me standardet e përcaktuara në Rekomandimin e Përgjithshëm të Komitetit CEDAW Nr.35.

Burimi i informacionit: Analizë e standardeve; raporte monitoruese të aktivitetit të linjave; intervistë me punonjës të linjës kombëtare të këshillimit dhe përfituese, raporte të punës së MR në bashki të ndryshme, etj.

- Numri i linjave telefonike 24-orëshe në nivel kombëtar dhe lokal, që ofrojnë këshillim për viktimat, në mënyrë konfidenciale, në lidhje me të gjitha format e dhunës me bazë gjinore;
- Numri i përfituesve të këtij shërbimi, çdo vit.
- Numri i raportimit pranë mekanizmave të referimit si dhe numri i rasteve të

27 Me mbështetjen e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim PNUD dhe fonde të Qeverisë së Turqisë janë ngritur klinika ligjore në Durrës, Tiranë, Fier dhe Lezhë;

regjistruara ne sistemin REVALB.

- Përqindja e thirrjeve drejtuar linjave telefonike, të ndara sipas formës së dhunës;
- Burimet e financimit të linjës kombëtare të këshillimit dhe shuma vjetore për këtë program;
- Përqindja e fondeve nga buxheti vjetor dedikuar për funksionimin e linjës kombëtare të këshillimit dhe/ose linjave telefonike 24-orëshe (24/7) që ofrojnë këshilla falas për telefonuesit, në lidhje me të gjitha format e dhunës me bazë gjinore në krahasim me buxhetin total për shërbimet në këtë fushë. (të dhënat mbi buxhetin e linjave telefonike të këshillimit të ndara në nivel kombëtar dhe lokal)
- Të dhëna në lidhje me trajnimin e stafit të linjës kombëtare të këshillimit dhe/ose linjave telefonike dhe specializimin e tyre për të këshilluar rastet e formave të ndryshme të dhunës ndaj grave dhe këshillimin edhe të dëshmitarëve të dhunës në përputhje me moshën e tyre;

Burimi i informacionit: Raporte të aktivitetit të linjave telefonike; raporte vjetore të MSHMS dhe bashkive të ndryshme ku është ngritur MR dhe funksionojnë linjat telefonike falas; Intervista me stafin e linjave telefonike; etj.

- Të dhëna në lidhje me fushatat ndërgjegjësuese që kanë si synim të nxisin numrin e raportimeve të rasteve të dhunës me bazë gjinore si edhe të dhëna mbi buxhetimin e fushatave ndërgjegjësuese.

Burim informacioni: Studime të Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve mbi identifikimin e fushatave ndërgjegjësuese që kanë pasur impakt pozitiv te publiku për ndërgjegjësim dhe raportim të rasteve të dhunës

- Të dhëna në lidhje me trajnimin e medias për konfidencialitetin e të dhënave.

Në lidhje me raportimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore ju mund të kërkonte informacion në lidhje me:

- Përqindja e raportimeve të dhunës me bazë gjinore të bëra nga dëshmitarët ose viktimat në krahasim me numrin total të të gjitha formave të dhunës së raportuar çdo vit.

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar DPPSH dhe/ose drejtorive të policisë në qarqe, komisariateve të policisë; Kërkesë për informacion drejtuar bashkive të ndryshme ku janë ngritur MR, koordinatorëve vendorë kundër dhunës në familje;

- Numri i fushatave dhe/ose iniciativave në nivel lokal, që synojnë të rrisin ndërgjegjësimin për rëndësinë e raportimit të dhunës me bazë gjinore të kryera çdo vit nga a) MSHMS, b) Ministrinë e linjës c) organizatat joqeveritare dhe d) bashkitë.

Burimi i informacionit: raporte të MSHMS, raporte të OJF-ve, raporte të bashkive, kërkesa për informacion drejtuar bashkive; intervista me drejtues të OJF-ve, etj.

- Numri i shërbimeve mbështetëse për viktimat dhe dëshmitarët e dhunës me bazë gjinore, të ngritura gjatë vitit të fundit a) në nivel qendror dhe b) në nivel vendor; c) në nivel qarku;

Burimi i informacionit: raporte të SHSSH dhe DRSHSSH, raporte të MSHMS, raporte të MR; raporte të bashkive; raporte monitorimi të MR; etj.

- Numri i raportimeve të bëra në a) polici; b) pranë koordinatores vendore kundër dhunës në familje në nivel vendor dhe c) institucione të tjera përgjegjëse, anëtare të MR, në vështrim krahasues;
- Niveli i përputhshmërisë së konfidencialitetit të bazës së të dhënave të viktimave dhe dëshmitarëve të dhunës në raport me standardet/rregullat e pranuar ndërkombëtarisht në lidhje me raportimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore;

Burimi i informacionit: Numri i ankesave;

- Numri i rasteve/kërkesave për UM dhe UMM të iniciuara kryesisht nga prokuroria/policia pas dëshmisë së dhënë nga viktimat e dhunës në familje;

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar DPPSH dhe/ose drejtorive të policisë në qarqe, komisariateve të policisë; Kërkesë për informacion drejtuar bashkive të ndryshme ku janë ngritur MR, koordinatorëve vendorë kundër dhunës në familje;

REKOMANDIM Nr.13 (d): Të ndryshojë barrën e provës në rastet e pretenduara për diskriminim mbi bazë seksi ose me bazë gjinore në favor të ankuesve.

Në lidhje me ndryshimin e barrës së provës në rastet e pretenduara për diskriminim me bazë seksi mund të përdorni si tregues:

- Niveli i përputhjes së dispozitave ligjore që përcaktojnë barrën e provës në rastet e diskriminimit gjinor me parashikimet e Konventës CEDAW; Analizë ligjore e ndryshimeve në ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”/ Kodi i Punës në lidhje me përmbyshjen e barrës së provës;

Burimi i informacionit: desk study;

- Përqindja e vendimeve gjyqësore në të cilat provat që lidhen me historinë seksuale dhe sjelljen e viktimës janë pranuar si të rëndësishme dhe të nevojshme nga gjykata, në krahasim me numrin e përgjithshëm të vendimeve gjyqësore mbi dhunën me bazë gjinore;
- Të dhëna në lidhje me vendimet gjyqësore të rrëzuara nga gjykata për shkak të mungesës së provave të mjaftueshme nga viktimat e diskriminimit;

Burimi i informacionit: Kërkesë për informacion drejtuar gjykatave të rretheve gjyqësore; raporte të OJF-ve që punojnë në këtë fushë; web e OJF-ve që punojnë në këtë fushë; vendime gjyqësore, intervista me avokate që punojnë për OJF-të, gjyqtarë, staf të KMD, etj.;

- Të dhëna në lidhje me numrin e ankesave/informacioneve të paraqitura pranë KMD, me pretendimin për diskriminim për shkak të seksit;

- Të dhëna në lidhje me vendimet në të cilat KMD ka gjetur diskriminim dhe ka zbatuar barrën e përmbysur të provës, për këto çështje;
- Të dhëna në lidhje me vendimet në të cilat KMD ka vendosur pushim ose nuk ka gjetur diskriminim për këto çështje;

Burimi i informacionit: Raporte vjetore të paraqitura në Kuvend nga KMD; web i KMD, vendime të KMD; Rezoluta të Kuvendit për raportet e KMD; etj.

Burimi i informacionit: ankesa të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit;

REKOMANDIM Nr.23 (d): Të forcojë sistemin e zbatimit të vendimeve të gjykatës, në veçanti atyre që kanë të bëjnë me urdhrat e mbrojtjes apo urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve të personelit gjyqësor, si përmbaruesit gjyqësorë.

Në lidhje me zbatimin e vendimeve gjyqësore, dhe sidomos për UM dhe UMM:

- Numri i nëpunësve publikë (të ngarkuar me detyrimin ligjor për të zbatuar Urdhrat e Mbrojtjes dhe Urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes) të trajnuar profesionalisht në lidhje me çështje të dhunës me bazë gjinore dhe në mënyrë të veçantë për zbatimin e UMM/UM në periudhën 2016-2018;
- Numri i trajnimeve të zhvilluara gjatë dy viteve të fundit me këtë objekt për a) punonjësit e zyrave të përmbarimit; b) punonjësit e policisë; c) punonjës të Zyrave të Shërbimeve Sociale pranë bashkisë; d) ekipet teknike të MR; e) OJF;

Burimi i informacionit: Analiza vjetore të institucioneve si MD, DPPSH, bashkive, OJF-ve; etj.

- Përqindja e rasteve të dhunës së raportuar ku viktimave, të pajisura me UMM/UM nuk iu është siguruar mbrojtja e shpejtë dhe adekuate nga autoritetet përkatëse (policia/përmbaruesit/ punonjësit social);
- Numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje që kanë humbur jetën, ndonëse kanë qenë të pajisura me UMM/UM ose ndaj të cilave është vazhduar te ushtrohet dhune pavarësisht denoncimeve të bëra gjatë kohës që kanë qenë të pajisura me UM.

Burimi i informacionit: Raporte të DPPSH, media, OJF që mbështesin viktimat e dhunës me bazë gjinore; Ankesa të paraqitura pranë institucionit të AP, raporte vjetore²⁸ ose të veçanta²⁹ të institucionit të AP;

- Përqindja e vendimeve gjyqësorë të UMM/UM, të zbatuara në lidhje me dhunën me bazë gjinore;

Burimi i informacionit: të dhëna nga DPPSH, MD, të dhëna nga zyrat e përmbarimit, zyrat e shërbimeve sociale pranë bashkive komisaritetet e policive, etj.;

- Mjete ligjore për mbrojtjen urgjente për viktimat e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore;

28 Kështu në raportin vjetor të AP për vitin 2016 janë ngritur disa çështje dhe shqetësime me të cilat përballen viktimat e dhunës me bazë gjinore përfshirë viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare. http://www.avokatipopullit.gov.al/sites/default/files/RAPORTET/RAPORTET_VJETORE/Raporti_2016.pdf

29 Raportet e veçanta të institucionit të AP si raporti për gjakmarrjen 2, raporte për dhunën në familje, etj përbëjnë një burim të rëndësishëm informacioni.

Burimi i informacionit: analizë ligjore;

- Numri i dhunueseve të ndëshkuar për shkelje të urdhrave mbrojtjes, në krahasim me numrin e përgjithshëm të urdhrave të tilla;
- Numri i procedimeve penale efektive dhe të shpejta në rastet e shkeljes së UMM/UM, çdo vit.

Burimi i informacionit: Vjetari statistikor i MD, të dhëna nga DPPSH;

- Numri i masave disiplinore të marra nga SHKB dhe KLD për profesionistët e sistemit që nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore në zbatim të UMM/UM;

Burimi i informacionit: Ankesa të paraqitura për mospërmbushje të detyrimeve ligjore nga punonjësit përgjegjës; raporte të OJF-ve që ofrojnë shërbim ligjor falas për viktimat e dhunës në familje, kërkesa për informacion drejtuar SHKB, kërkesa për informacion drejtuar KLD; përgjigje zyrtare nga këto institucione, etj.

1.18. Si mund të përdorë institucioni i AP vërejtjet përmbyllëse të Komitetit CEDAW?

Institucioni i AP përgatit një Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit CEDAW. Institucioni bashkëpunon me aktorët shtetërorë dhe OJF-të për zbatimin e VP të Komitetit CEDAW.

Çfarë duhet të dimë për Konventën “Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (Konventa e Stambollit)?

Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) është një konventë e Këshillit të Evropës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje e cila u hap për nënshkrim në 11 maj 2011, në Stamboll të Turqisë. Konventa është instrument i pari i këtij lloji, që trajton në mënyrë specifike dhunën ndaj grave, që ka fuqi ligjore dhe që është e hapur për të gjitha vendet e botës; është i gjithanshëm, sepse përfshin masa në fushën e parandalimit të dhunës, mbrojtjes së viktimave, ndjekjes penale të autorëve të dhunës, si edhe në fushën e politikave të integruara; u kërkon shteteve të parashikojnë si vepra penale format kryesore të dhunës ndaj grave dhe të sigurojnë sanksione të mjaftueshme dhe të efektshme kundër tyre; është i pajisur me një mekanizëm të fortë dhe të pavarur monitorimi, dhe një rol specifik për parlamentarët në mbikëqyrjen e zbatimit të Konventës në nivel kombëtar. Gjithashtu, i kërkohet Asamblesë Parlamentare të vrojtojë rregullisht zbatimin e një instrumenti të tillë.

Konventa është një instrument shumë gjithëpërfshirës i cili është ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 104/2012, datë 8.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës” Për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje “. Konventa hyri në fuqi më 1 gusht 2014.

Cili është kuptimi i koncepteve “dhunë ndaj grave”, “dhunë në familje”, “gjinia/përkatesia gjinore”, “dhuna gjinore ndaj grave”, “viktima”, bazuar në Konventën e Stambollit?

Dhuna ndaj grave përkufizohet si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë diskriminimi ndaj grave dhe përfshin të gjitha aktet e dhunës gjinore që çojnë ose mund të çojnë në dëmtim ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike apo ekonomike për gratë, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike, qoftë në atë private.

Dhuna në familje nënkupton të gjitha llojet e dhunës si më lart, por që ndodhin brenda familjes ose njësisë shtëpiake, ose ndërmjet ish-bashkëshortëve ose partnerëve ose ndërmjet bashkëshortëve ose partnerëve aktualë, pavarësisht nga fakti nëse dhunuesi jeton apo ka jetuar ndonjëherë me viktimën. Kjo mbulon viktimat dhe autorët e të dyja gjinive dhe përfshin edhe dhunën ndaj fëmijëve dhe të moshuarve, si edhe dhunën mes partnerëve në marrëdhënie intime.

Gjinia/përkatësia gjinore nënkupton rolet që u cakton shoqëria burrave dhe grave, si edhe sjelljet, veprimtaritë dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat.

Dhuna gjinore ndaj grave është dhuna që ka si shënjestër gratë pikërisht pse janë gra (siç është ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas, gjymtimi i organeve gjenitale të femrave) ose që prek gratë shumë më tepër sesa burrat (si dhuna seksuale, përdhunimi, përndjekja, ngacmimi seksual, dhuna në familje, detyrimi për martesë dhe sterilizimi forcërisht).

Viktima nënkupton viktimat e dhunës ndaj grave dhe viktimat e dhunës në familje.

Cilat janë detyrimet që ka shteti Shqiptar në kuadër të zbatimit të Konventës?

Konventa u kërkon qeverive të përmbushin standardet specifike për të parandaluar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore kundër grave, për të mbrojtur viktimat e një dhune të tillë dhe për të ndjekur penalisht ata që kryejnë dhunën. Shteti duhet të marrë një sërë masash që lidhen;

- Parandalimin e Dhunës
- Mbrojtjen dhe Mbështetjen e viktimave të dhunës
- Ndëshkimin e dhunuesve
- Politikat e integruara

Kështu në zbatim të detyrimeve të mësipërme shteti shqiptar duhet të ndërmarrë një sërë masash që lidhen me ndryshimet ligjore, në shërbime, në mentalitet etj. Meqenëse asnjë agjenci ose institucion nuk mund të punojë vetëm në adresimin e dhunës apo mbrojtjen e viktimave të dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, konventa inkurajon përfshirjen e agjencive qeveritare (institucionet ligjzbatuese, gjyqësorin, arsimin dhe shëndetësinë) për të bashkëpunuar me OJF-të që ofrojnë shërbime të specializuara mbështetëse.

Cili është mekanizmi që garanton dhe monitoron zbatimin e Konventës?

Për të siguruar që Konventa të zbatohet në mënyrë të efektshme nga shtetet dhe me qëllim që përdorimi i saj nga viktimat dhe profesionistët ligjorë të jetë mjet efektiv është krijuar edhe mekanizmi, i cili mbikëqyrë zbatimin e saj.

Mekanizmi monitorues i Konventës së Stambollit përbëhet nga dy trupa të dallueshëm, por bashkëveprues:

Dy organet e mekanizmit janë;

Grupi i ekspertëve për masat kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – një organ teknik, i pavarur i quajtur “GREVIO” që përbëhet nga 10 deri në 15 anëtarë, që janë ekspertë për të drejtat e njeriut, barazinë gjinore, dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje apo për mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave. Ky grup përbëhet nga shtetas të Palëve të Konventës dhe ka një ekuilibër gjinor, disiplinor dhe gjeografik. Roli i këtij grupi është të masë shkallën me të cilën e kanë zbatuar Konventën Palët.

Komiteti i Palëve – është një organ politik që përbëhet nga përfaqësuesit e Palëve në Konventë, të cilët do të zgjedhin anëtarët e grupit GREVIO nga kandidatët e propozuar nga Palët. Gjithashtu, Komiteti i Palëve ndjek raportet dhe konkluzionet e GREVIO-s dhe i miraton rekomandimet e Palëve të interesuara.

Cila janë procedurat e ndjekura nga GREVIO me qëllim monitorimin e shtetit?

Konventa e Stambollit parashikon dy lloje procedurash monitorimi:


- **Një procedurë vlerësimi për vendin**
- **Një procedurë hetimore e veçantë.**

Çfarë parashikon procedura e vlerësimit për vendin?

1. Procedura e Raportimit për shtetet palë fillon **me dorëzimin pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës**, të një raporti mbi masat legislative dhe të tjera që i bëjnë dispozitat e kësaj Konvente të zbatueshme, për shqyrtim nga GREVIO. Ky raport **hartohet mbi bazën e një pyetësi të përgatitur nga GREVIO**, i cili iu dërgohet shteteve. GREVIO merr në shqyrtim raportin dhe vijon me procedurat e vlerësimit të mëtejshme, të cilat **ndahen në runde**, kohëzgjatja e së cilave përcaktohet nga GREVIO. Në fillim të çdo rundi GREVIO zgjedh **dispozitat e veçanta mbi të cilat bazohet procedura e vlerësimit dhe dërgon një pyetësor**. GREVIO përcakton mjetet e duhura për të kryer këtë procedurë monitorimi, duke miratuar rregullat e veta të procedurës. Ajo në veçanti mund të miratojë një pyetësor për çdo rund vlerësimi, e cila shërben si një bazë për procedurën e vlerësimit të zbatimit nga Palët. Ky pyetësor i drejtohet të gjitha Palëve. Palët i përgjigjen këtij pyetësori, si dhe çdo kërkesë tjetër për informacion nga GREVIO. Në këtë fazë GREVIO mund të marrë informacion mbi zbatimin e Konventës nga organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile, si dhe nga institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst, GREVIO konsideron informacionin e paraqitur nga Palët në përgjigje të pyetësorëve të saj ose ndonjë kërkesë tjetër për informacion, duke marrë parasysh informacionet e marra nga organet përkatëse të Këshillit të Evropës, institucionet e themeluara me instrumente të tjera ndërkombëtare (si Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, Komiteti CEDAW), organizatat joqeveritare dhe institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut.

2. Nëse informacioni i fituar është i pamjaftueshëm, GREVIO mund të organizojë vizita vendi, në të cilat marrin pjesë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit .
3. GREVIO miraton raportet e tij përfundimtare dhe i dërgon ato tek palët e interesuara dhe Komiteti i Palëve. Raportet dhe konkluzionet e GREVIO bëhen publike që nga miratimi i tyre, së bashku me komentet e Palëve të interesuara. Komiteti i Palëve mund të miratojë, në bazë të raporteve dhe konkluzioneve GREVIO, rekomandime specifike në lidhje me masat që duhet të ndërmerren për zbatimin e konkluzioneve të GREVIO, për t'u zbatuar nga Pala në fjalë brenda një date të caktuar.

Në mënyrë të përmblodhur procedura e vlerësimit



1. Vizitat në vende organizohen kur është e nevojshme.
2. Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës.


Në cilat raste GREVIO vendos të ndërmarrë një procedurë hetimi?

1. Një procedurë hetimore e posaçme mund të fillojë nga GREVIO kur ka **informata të besueshme** që tregojnë se veprimi kërkohet **për të parandaluar**

një model serioz, masiv ose të vazhdueshëm të çdo akti të dhunës të mbuluar nga Konventa si dhe **një situatë ku problemet kërkojnë vëmendje të menjëhershme për të parandaluar ose kufizuar shkallën ose numrin e shkeljeve të rënda** të Konventës. Këtë informacion të besueshëm GREVIO mund ta marrë edhe nga institucioni i Avokatit të Popullit.

2. Në një rast të tillë, GREVIO mund të kërkojë **paraqitjen urgjente të një raporti të veçantë** nga Pala e interesuar. Duke marrë parasysh informatat relevante në dispozicion, GREVIO mund të caktojë një ose më shumë nga anëtarët e saj për të kryer një hetim dhe për të raportuar.
3. Kur është e garantuar dhe me pëlqimin e Palës, hetimi mund të përfshijë **një vizitë në vend**. Takimet me përfaqësues të institucionit të AP mund të jenë pjesë e rëndësishme e vizitave.
4. Pas shqyrtimit nga GREVIO, gjetjet e hetimit i dërgohen shtetit dhe kur është e përshtatshme, Komitetit të Palëve dhe Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, së bashku me komentet dhe rekomandimet.

Procedura urgjente e hetimit



Çfarë roli mund të luajë Avokatit i Popullit në zbatimin dhe monitorimin e Konventës së Stambollit?

Avokati i Popullit luan një rol të rëndësishëm edhe në garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të viktimeve të dhunës.

Avokati i Popullit kontribuon në përmirësimin e zbatimit të të drejtave të viktimeve nga institucionet shtetërore përgjegjëse, nëpërmjet monitorimit të punës së tyre në frymën e zbatimit të detyrimeve të Konventës.

Kështu në raportin e parë për Shqipërinë të grupit të ekspertëve të pavarur GREVIO nxit autoritetet shqiptare të studiojnë mjetet e mundshme për të rritur ndërgjegjësimin rreth natyrës diskriminuese të DHKG dhe **ritjen e rolit të institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi si mbrojtës të viktimeve të DHKG**. Nëpërmjet këtij rekomandimi ekspertët e GREVIO' s e kanë njohur rolin e rëndësishëm që ka Avokati i Popullit në mbrojtjen e viktimeve të dhunës dhe nxisin shtetin që të marrë masa të forcojë rolin e këtij institucioni.

Avokati i Popullit mund të angazhohet në forma të ndryshme gjatë procesit të monitorimit të Konventës së Stambollit prej momentit të fillimit të procedurës së vlerësimit të shtetit nga grupi i ekspertëve të Këshillit të Evropës por edhe në fazën e procedurës së hetimit.

Vlerësimi fillestar i shteteve mbi zbatimin e Konventës bëhet mbi bazën e plotësimit të pyetësorit të GREVIOS nga ana e shteteve palë. Në këtë fazë GREVIO fton mekanizmat e mbrojtjes së të drejtave të njeriut si Avokati i Popullit të bëhen pjesë e procesit, duke i dërguar atij informacion shtesë bazuar në raportin e shteteve. Gjithashtu, GREVIO mund të vizitojë shtetin nën monitorim për të vlerësuar më nga afër nivelin e zbatueshmërisë së Konventës në vend. Gjatë kësaj faze, përfaqësuesit e GREVIO-s mund të zhvillojnë takime me institucionin e Avokatit të Popullit, me qëllim që të marrin informacion, të dhëna në lidhje me problematikat më shqetësuese në vend për çështjet e mbuluara nga Konventa.

Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të kontribuojë edhe në procedurën e hetimit. Në këtë fazë Konventa ka parashikuar se nëse GREVIO merr informacion të besueshëm që tregon një situatë ku problemet kërkojnë vëmendje të menjëhershme për të parandaluar ose kufizuar shkallën ose numrin e shkeljeve të rënda të Konventës, ajo mund të kërkojë paraqitjen e menjëhershme të një raporti të veçantë në lidhje me masat e marra për të parandaluar një model serioz, në masë ose të vazhdueshme të dhunës ndaj grave. Këtë informacion të besueshëm GREVIO mund ta marrë nëpërmjet mekanizmave kombëtare që mbrojnë të drejtat e njeriut, si institucioni i Avokatit të Popullit. GREVIO duke mbajtur parasysht informacionin e paraqitur nga Pala e interesuar, si dhe çdo informacion tjetër të besueshëm në dispozicion të tij, mund të caktojë një ose më shumë nga anëtarët e tij për të kryer një hetim dhe për të raportuar menjëherë në GREVIO. Kur garantohet dhe me pëlqimin e Palës, hetimi mund të përfshijë një vizitë në territorin e saj.

Çfarë do të kuptojmë me monitorim sipas Konventës?

Sipas Konventës së Stambollit, **'monitorimi'** nënkupton vëzhgimin se si dhe sa me

efikasitet politikat dhe masat kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje janë zbatuar në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal. Monitorimi përfshin elementë të matjes dhe vlerësimit.

Si mund të marrë pjesë Avokati i Popullit në procesin e monitorimit?

Institucioni i Avokatit të Popullit mund të bëhet pjesë aktive e GREVIO përmes ushtrimit të secilës prej kompetencave të mëposhtme:

- Promovon zbatimin e Konventës së Stambollit, dhe rekomandimeve të grupit të ekspertëve të pavarur GREVIO;
- Monitoron punën e shtetit nëpërmjet marrjes së masave legjislative, praktikës gjyqësore, administrative, si dhe zbatimin e rekomandimeve të grupit të ekspertëve të pavarur GREVIO;
- I parashtron GREVIO-s informacion të besueshëm në lidhje me situatën e të drejtave të grave në shtetin e tij, të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit të tij;
- Përgatit raporte ose/dhe informacione me gojë në takimet e realizuara me grupin e ekspertëve. Këto raporte lidhen me informacionin e marrë mbi zbatimin e disa ose të gjitha dispozitave të Konventës ose temave specifike që fokusohen në boshllëqet e zbatimit të Konventës ose rekomandimeve të grupit të ekspertëve të pavarur GREVIO.
- Mund të paraqesin raporte/ informacion të besueshëm përpara GREVIO-s kur ka konstatuar shkelje të rënda dhe të vazhdueshme të Konventës.
- Të paraqesin inpute në lidhje me rekomandimet e posaçme dhe të përgjithshme të GREVIO dhe të përdorin këto rekomandime në përpjekjet e tyre advokuese;
- Mund të përdor Konventën dhe detyrimet e saj për një dialog të vazhdueshëm me qeverinë dhe parlamentin;
- Organizon aktivitete që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit dhe edukimin për të drejtat e njeriut, dhunën në familje dhe dhunën kundër grave.

Për sa më sipër institucioni i AP mund ta shndërroi Konventën në një instrument për fuqizimin e të drejtave të grave përmes monitorimit, advokacisë dhe lobimit për zbatimin e Konventës dhe rekomandimeve të GREVIO-S.

Pse është e rëndësishme për institucionin e A.P. të marrë pjesë në procedurën e monitorimit të GREVIO-s?

Pjesëmarrja e institucionit të A.P. në procedurën e monitorimit të GREVIO do të sjellë efekte pozitive dhe do të ndikojë në përmirësimin e situatës së grave dhe në promovimin e standarteve ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të grave dhe viktimave të dhunës në familje dhe dhunës kundër grave brenda vendit.

- Institucioni i A.P. mund të ndikojë në procesin e vlerësimit të GREVIO për Shqipërinë dhe në hartimin e rekomandimeve përfundimtare për shtetin.
- Institucioni i A.P. zotëron informacion të përditësuar dhe të pasur me eksperiencë të drejtëpërdrejta të shkeljes së të drejtave të grave viktime të dhunës në familje

dhe dhunës me bazë gjinore si rezultat i punës së përditshme.

- Institucioni mund të ndërtojë ura komunikimi midis Këshillit të Evropës dhe aktorëve politikë në vend.
- Institucioni i A.P. mund t'i jap mekanizmit të monitorimit të KE informacion të pasur me të dhëna statistikore dhe analitike të mbledhura gjatë veprimtarisë së tij në këtë fushë që mund të hedhin dritë mbi trendet dhe problematikat në ligj dhe praktikë.
- Institucioni i A.P. mund të ndikojë pozitivisht në punën dhe efikasitetin e mekanizmit të monitorimit me qëllim zbatimin efektiv të konventës së Stambollit.

Si mund të marr pjesë Avokati i Popullit në procesin e monitorimit të GREVIO-s?

Institucioni i Avokatit të Popullit mund të bëhet pjesë aktive e procesit të monitorimit të GREVIO-s duke ndjekur një ose disa nga mundësitë e mëposhtme:

- Nëpërmjet dërgimit të raporteve alternative ose raporteve hije GREVIO-s duke iu përgjigjur të gjitha ose disa pjesëve të pyetësorit të shtetit;
- Pas publikimit të raportit të shtetit, institucioni mund t'i ofrojë mekanizmit të monitorimit informacion ose të dhëna shtesë që mungojë ose janë kontradiktore në raportin e shtetit;
- Institucioni i A.P. mund t'i ofroi GREVIO-s informacion të rëndësishëm për ta ndihmuar atë në përgatitjen dhe identifikimin e prioritetëve për shtetin që po monitoron;
- Institucioni i A.P. mund të ketë mundësi të takoheni me përfaqësuesit e GREVIO-s gjatë vizitave në shtetin tuaj për të sjellë në vëmendjen e tyre situatën reale të të drejtave të grave në vend.
- Institucioni i A.P. mund të angazhohet në dialogun me aktorët politikë në vend duke i kërkuar zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Konventa dhe zbatimin në kohë të rekomandimeve të GREVIO-s.
- Institucioni i A.P. mund të bëhet pjesë aktive e procedurës follow-up duke monitoruar dhe ose ndihmuar shtetin në përmbushjen e rekomandimeve të GREVIO-s.

Çfarë ka parashikuar rregulli 35 “Rregullat për procedurën” në lidhje me marrjen e informacionit nga institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut?

GREVIO mund t'i ftojë institucionet kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut për të marrë informacion nëpërmjet:

- një pyetësor të miratuar sipas Rregullit nr. 33³⁰;
- kërkesa të tjera për informacione të bëra sipas Rregullit 34³¹;
- çdo çështje tjetër relevante në kontekstin e procedurës së vlerësimit.

30 Rules of Procedures, rule nr.33 <https://rm.coe.int/grevio-inf-2015-rop-rev-eng/1680710554>

31 Rules of Procedures, rule nr. 34 <https://rm.coe.int/grevio-inf-2015-rop-rev-eng/1680710554>

GREVIO do të trajtojë informacionin e dhënë në zbatim të këtij rregulli si konfidencial, përveç nëse vendoset ndryshe nga GREVIO me kërkesë të institucionit, apo aktorit në fjalë.

Çfarë gjuhe komunikimi duhet të përdorë Avokati i Popullit me GREVIO?

Raportet dhe përgjigjet në pyetësorët dhe kërkesat për informacion, si dhe informacione të tjera të adresuara GREVIO-s do të dorëzohen në një nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Evropës (Anglisht ose frëngjisht). Ndërsa nëse institucioni i Avokatit të Popullit behët pjese e takimeve që organizon GREVIO ne shtetet palë mund të komunikojë në gjuhën shqip pasi grupi i ekspertëve ka përkthyes si dhe ekspertë të fushës që i shoqëron gjatë vizitave ne vende.

Cilat janë çështjet që Avokati i Popullit mund ti çmojë si të rëndësishme për ti paraqitur përpara Kuvendit me qëllim zbatimin e Konventës dhe rekomandimeve të GREVIO-s?

Në muajin nëntor 2017, GREVIO, Grupi i Ekspertëve për masat kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje botoi raportin e parë për Shqipërinë. Raporti i GREVIO' s për Shqipërinë përmban rekomandime të rëndësishme për shtetin shqiptar dhe mund të përbëjë një plan veprimi për punën e Avokatit të Popullit.

Kështu, në dhënien e rekomandimeve, GREVIO ka përdorur terma të ndryshme që i korrespondojnë niveleve të ndryshme të urgjencës, duke tërhequr vëmendjen se të gjitha janë të rëndësishme. Këto terma konsistojnë në: **“kërkon”** (veprime të menjëhershme kërkohen për të përqsur legjislacionin ose politikat e shtetit me Konventën e Stambollit, ose për të siguruar zbatimin e saj); **“nxit fuqimisht”** është përdorur për boshllëqe që nevojiten të rregullohen në të ardhmen e afërt, me qëllim që të sigurohet një zbatim gjithëpërfshirës i Konventës; **“nxit”**, është përdorur për boshllëqe që kërkojnë vëmendje, edhe pse në një fazë të mëvonshme; **“fton”** shënon boshllëqe të vogla në zbatim, për të cilat autoriteteve i është kërkuar t'i konsiderojnë dhe t'i mbyllin. Në këtë kuadër Avokati i Popullit mund të kërkojë të dëgjohet nga Parlamenti, për çështje që ai i çmon të rëndësishme por edhe në përputhje me nivelin e urgjencës së rekomandimeve të dhëna nga ekspertet e GREVIO-s, të cilat kanë kërkuar marrjen e masave të menjëhershme nga shteti shqiptar.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka disa detyrime të ngarkuara nga Konventa; **së pari**, parlamentet kombëtare ftohen të marrin pjesë në monitorimin e masave të marra për zbatimin e kësaj Konvente, **së dyti**, palët paraqesin raportet e GREVIO në parlamentet e tyre kombëtare. Avokati i Popullit mund të ndërmarrë veprime të përbashkëta me Kuvendin me qëllim zbatimin e Konventës dhe monitorimin e zbatimit të saj. Gjithashtu, Avokati i Popullit në zbatim të rezolutës “Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektivitetit të mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj”, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 4 dhjetor 2017 mund të kontribuojë për përgatitjen e një plani veprimi dhe propozimin e masave konkrete pranë nënkomisionit të përhershëm “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas” pranë Komisionit përgjegjës për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë me qëllim zbatimin e rekomandimeve të GREVIOS.

Roli i Avokatit të Popullit për të rekomanduar ndryshime ligjore përpara Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Konventa e Stambollit është instrumenti i parë evropian ligjërish i detyrueshëm që ofron standarde për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Gjithashtu, shërben si një instrument për të promovuar barazi më të madhe midis grave dhe burrave. Kjo Konventë është dokumenti i parë ndërkombëtar që përkufizon dhunën kundër grave; dhuna në familje; gjininë; dhuna me bazë gjinore ndaj grave (Neni 3). Konventa përcakton format e mëposhtme të dhunës kundër grave: dhuna psikologjike (neni 33), përndjekja (Neni 34), dhuna fizike (neni 35), dhuna seksuale, përfshirë përdhunimin (neni 36), martesë e detyruar (neni 37), gjymtimi gjeneral femëror (neni 38), aborti i detyruar dhe sterilizimi i detyruar (neni 39), ngacmimi seksual (neni 40). Në lidhje me përkufizimin e dhunës në familje, GREVIO nxit fuqimisht autoritetet shqiptare të marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë këtu masa legjislative, për të njëtrajtësuar përkufizimin e dhunës në familje, në ligjin vendas, me atë të Konventës, si dhe për të siguruar zbatimin efektiv në praktikë të këtij përkufizimi të njëtrajtësuar. Autoritetet duhet të paraqesin më tej një qasje të qartë gjinore, në legjislacionin e tyre, për të njohur plotësisht natyrën me bazë gjinore të dhunës në familje, e cila prek kryesisht gratë dhe vajzat (paragrafi 9). Referuar gjetjes së ekspertëve të GREVIO-s rezultoi se përkufizimi i dhunës në familje nuk është i njëtrajtësuar me legjislacionin tonë të brendshëm. Në këto kushte, institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrim të një prej të drejtave të tij mund të propozojë Kuvendit ndryshime ligjore në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje dhe rekomandimeve të grupit të ekspertëve të GREVIO-s për ndryshime ligjore.

Nga mund të marrë Avokati i Popullit informacion/të dhëna për zbatimin e Konventës dhe monitorimin e saj?

- *Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me organizata jofitimprurëse.*

Avokati i Popullit mund të bashkëpunojë me organizatat që ofrojnë shërbim ligjor falas për viktimat e dhunës me bazë gjinore, shërbim psikologjik, shëndetësor, riintegrimin e tyre, OJQ që kanë programe rehabilituese për dhunuesit me qëllim që të marrë periodikisht mendimet e tyre për problematikat e hasura nga viktimat e dhunës në familje dhe zbatimin e ligjeve nga institucionet. Avokati i Popullit mund të bashkërendojë punën e tij në mbrojtje të të drejtave të njeriut edhe me Rrjetin e Monitorimit të dhunës me baze gjinore³², ku mund të marrë të dhëna të përditësuara për aspekte të ndryshme të Konventës. Grupi i ekspertëve të veprimit mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje (GREVIO) ka njohur dhe vlerësuar kontributin e OJF-ve në të gjithë procesin e monitorimit të Konventës dhe përmbushjes së rekomandimeve për zbatimin efektiv të saj, duke i konsideruar ato si një burim kyç informacioni gjatë gjithë procesit kështu që në këtë kuadër Avokati i Popullit mund të bashkëpunojë me OJF si një burim i rëndësishëm informacioni.

- *Informacion nëpërmjet ankesave/ kërkesave që paraqesin viktimat e dhunës te institucioni i Avokatit të Popullit.*

32 <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/>

Viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare mund ti drejtohen institucionit për çështje që lidhen me cenimin e të drejtave të tyre nga institucione konkrete. Nëpërmjet ankesave apo edhe nëpërmjet organizatave jofitimprurëse viktimat e dhunës me bazë gjinore mund të kërkojnë ndërhyrjen e Avokatit të Popullit. Shërbimi është pa pagese. Viktimat mund të adresojnë çështjet e tyre nëpërmjet; ankesës online; ankesës më shkrim e dërguar me postë, duke u paraqitur personalisht në institucionin e Avokatit të Popullit, duke u paraqitur në zyrat rajonale të Avokatit të Popullit si dhe nëpërmjet mesazheve telefonike.

- *Informacion nga zyrat rajonale të Avokatit të Popullit*

Gjithashtu, informacioni i marrë nga zyrat rajonale (në Berat, Sarandë, Fier, Shkodër, Kukës, Pogradec etj) është një burim i rëndësishëm. Zyrat Rajonale u krijojnë qytetarëve, në mënyrë të veçantë grave një akses më të madh dhe zgjidhje më të shpejtë të ankesave të tyre ndaj administratës publike, kryesisht me organet e pushtetit vendor, si dhe shkurtojnë distancën fizike mes qytetarit dhe institucionit, për të aplikuar në marrjen e ankesave.

- *Informacion i marrë nga veprimtaria e përditshme e Institucionit të A.P*

Avokati i Popullit luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në garantimin e të drejtave të qytetarëve të parashikuara në ligj por edhe në përmirësimin e gëzimit të të drejtave të tyre nga organet e administratës shtetërore.

Institucioni i A.P vihet në lëvizje nga çdo individ, grup individësh ose organizata joqeveritare, që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat, liritë dhe interesat e tyre të ligjshme nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike.

Gjithashtu Avokati i Popullit mund të fillojë shqyrtimin e çështjes edhe me nismën e vet dhe në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura. Avokati i Popullit ka të drejtë të kryejë hetime në vend, përfshirë edhe hyrjen në çdo zyrë të institucioneve publike dhe këqyrjen në vend të akteve apo dokumenteve që kanë lidhje me çështjen që heton, të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin; të marrë në pyetje çdo person që, sipas tij, është i lidhur me çështjen nën hetim, dhe të thërrasë në zyrën e tij të gjithë personat pa imunitet; të kryejë ose të kërkojë ekspertiza.

Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës. Gjithashtu, ky institucion mund të fillojë të hetojë me kërkesën e qytetarëve, nga OJQ por edhe kryesisht kur vihet në dijeni për shkelje të të drejtave të njeriut. Kështu, Avokati Popullit duke u mbështetur, në ankesat e qytetarëve, informacionin e marrë nga ofjtë, rekomandimet e GREVIO' s mund të nis hetimet kryesisht për çështje të trajtuara nga ekspertët që kanë nevojë për vëmendjen e institucionit të tij. Edhe organizatat jofitimprurëse mund të luajnë një rol të rëndësishëm në adresimin e problematikave që hasin viktimat nga organet shtetërore.

Ligji i ka përcaktuar institucionit të AP një sërë të drejtash dhe detyrimesh të cilat ai mund ti përdor në zbatim edhe të detyrimeve të ngarkuara nga Konventa e Stambollit.

Avokati i Popullit referuar edhe Raportit të GREVIO' s konkretisht gjetjeve dhe sugjerimeve mund të ndërmarrë hetim të pavarur duke shqyrtuar punën e organeve të ngarkuara nga ligji për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

- *Marrja e informacionit nëpërmjet burimeve të tjera*
 - Informacion/të dhëna të marra nga institucione shqiptare;
 - Informacion/të dhëna të marra nga dokumentet/ burime zyrtare;
 - Informacion/të dhëna të prodhuara si rezultat i studimeve të kryera nga kërkues të pavarur ose nga universitetet;
 - Informacion/të dhëna të marra nga organizata ndërkombëtare ose nga OJF ndërkombëtare;

Pjesëmarrja e Avokatit të Popullit në të gjithë procesin e monitorimit nga GREVIO:

1. Brenda afatit të raportimit të shtetit

Ju mund të hartoni raporte të veçanta për nene të caktuara të Konventës apo për zbatimin e Konventës në tërësi dhe ndajini ato me GREVIO-n brenda datës së raportimit të shtetit

2. Pas publikimit të raportit të shtetit

- Ju mund të dërgoni raporte hiqe mbi raportin e shtetit duke ndarë me GREVIO-n informacione, të dhëna, komente në reagim të raportit të shtetit
- Përpquni të dërgoni raportet sa më parë pas publikimit të raportit të shtetit dhe përpara se GREVIO të nxjerrë vlerësimin e tij mbi raportin e shtetit

3. Përpara dhe gjatë vizitave të përfaqësuesve të GREVIOS:

- Merrni pjesë në tryezat e organizuara nga delegacioni i GREVIO-s
- Përgatisni informacion me shkrim për delegacionin mbi problematikat në zbatimin e Konventës nga shteti
- Asistoni në organizimin e takimeve me profesionistë të fushës

4. Pas publikimit të raportit të GREVIOS:

Promovoni Raportin e GREVIO-s dhe shpërndajeni atë.

5. Pas Publikimit të Rekomandimeve të Komitetit të Palëve:

Promovoni Rekomandimet

6. Vlerësimi Folloë-up: Jepni informacion mbi veprimet/mosveprimet e shtetit mbi zbatimin e rekomandimeve.

Çfarë strukture do ketë raporti i paraqitur nga Avokati i Popullit? A duhet raportuar mbi të gjitha nenet e Konventës?

Institucioni i Avokatit të Popullit në hartimin e raportit mund të bazohet në pyetësorin e përgatitur nga GREVIO për raportimin e shtetit.

- Megjithëse pyetësori mund të ndihmojë Institucionin e A.P të strukturojë raportin për GREVIO-n njëloj si ai shtetit, institucioni **NUK** është i detyruar

të raportoi mbi të gjitha aspektet e Konventës ose mbi të gjitha pyetjet e pyetësorit të GREVIO-s.

- Përpara se ta hartoni raportin rekomandohet të lexohet me kujdes **Raportin Shpjegues të Konventës** së Stambollit tek <https://rm.coe.int/16800d383a> për të kuptuar më mirë detyrimet e shtetit për zbatimin e Konventës.
- Fokusojeni raportin tuaj në zbatimin praktik të Konventës.
- Informacioni i dhëna nga ju duhet të jetë **Konciz dhe i qartë. Mbështeteni fort raportin me të dhëna të sakta statistikore** ose të mbledhura nga institucioni juaj.
- Përfshini në raport **zhvillimet pozitive mbi zbatimin e Konventës** dhe më pas **shqetësimet tuaja** në fushën që ushtroni veprimtarinë.
- Jepni **rekomandime konkrete** për përmirësimin e situatës.

Struktura e Raportit të Avokatit të Popullit:

1. Hyrje: Ju mund të jepni informacion të përgjithshëm mbi situatën e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje në Shqipëri

- Fakte dhe të dhëna statistikore mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje
- Informacion mbi indikatorët e tjerë të barazisë gjinore: arsimi/pjesëmarrja politike/paga/aksesi në shërbime etj

2. Ndiq strukturën e Konventës.

Për secilin Nen që kërkon të raportosh përcakto:

Të dhëna mbi situatën faktike

- Përpiquni të jeni sa më konciz
- Fokusohuni në çfarë nuk funksionon

Cilat janë problematikat dhe sfidat

- Mangësitë e shtetit në zbatimin e Konventës
- Jepni rekomandime konkrete
- Propozoni zgjidhje konkrete për situatat bazuar në kontekstin kombëtar

Rekomandimet që ju propozoni

- Rekomandimet të referohen tek autoritetet përgjegjëse për zbatimin e tyre.

Cilat janë masat urgjente të identifikuar nga GREVIO për të cilat duhet të raportojë Shqipëria dhe që mund të bëhen burim i monitorimit nga institucioni i Avokatit të Popullit?

Masat urgjente mund ti lexoni në linkun https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/ep-content/uploads/2018/03/IC-CP-Inf-2018-3_eng.docx.pdf

Disa prej tyre janë:

Rekomandimi 1

(Kapitulli I, Neni 2- Objekti i Konventës

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet që të ecin përpara me masat e tyre për dhunën ndaj grave duke garantuar që masat e marra në përputhje me Konventën e Stambollit të trajtojnë të gjitha format e dhunës ndaj grave, në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe tërësore. (paragrafi 4)

Rekomandimi 2

(Kapitulli I, Neni 3 – Përkufizimet referuar Dhunës në Familje)

GREVIO i nxit (i inkurajon fuqishëm) autoritetet shqiptare të marrin të gjitha masat e nevojshme, përfshirë masat legislative, për të harmonizuar përkufizimin e dhunës në familje brenda të drejtës familjare me Konventën, dhe për të garantuar një zbatim efikas të një përkufizimi të tillë të harmonizuar në praktikë. Autoritetet duhet të prezantojnë një qasje të qartë gjinore në legjislacionin e tyre për të pranuar tërësisht natyrën gjinore të dhunës në familje, e cila prek kryesisht gratë dhe vajzat (paragrafi 9)

Rekomandimi 10

(Kapitulli 2/D, Neni 11 – Mbledhja e e të dhënave dhe studimet, pika 1.

GREVIO i nxit (inkurajon fuqishëm) autoritetet shqiptare të:

- a.** kategorizojnë dhe pasqyrojnë në mënyrë më të qartë të dhënat për dhunën në familje ndaj grave dhe natyrën gjinore të formave të tjera të dhunës ndaj grave, në statistikat e publikuara për krimet, duke identifikuar qartazi numrin e grave viktimeve për çdo lloj veprë. Kjo mund të përfshijë paraqitjen e qartë të informacionit ndaj publikut për numrin e vrasjeve të grave nga burrat (vrasjet e grave të lidhura me gjininë);
- b.** zhvillojnë kategori të dhënash, për sa i përket llojit të marrëdhënies ndërmjet dhunuesit dhe viktimës, për të gjitha format e dhunës ndaj grave, që do të mundësonte dokumentimin më të qartë të natyrës së marrëdhënies së tyre.
- c.** sigurojnë që këto kategori dhe çdo kategori tjetër të dhënash në përdorim, duke përfshirë edhe llojin e dhunës dhe vendndodhjen ku është kryer vepra, të harmonizohen në shumë sektorë;
- d.** kryejnë studime për masën e dënimeve për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe të publikojnë rezultatet e studimeve të tilla (paragrafi 41)

Rekomandimi 30

(Kapitulli 5, Neni 29 – Paditë civile dhe mjetet ligjore)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet të:

- a.** përfshijnë elemente që lidhen me përgjegjësinë civile të nëpunësve publikë, në informacionin që u ofrohet viktimeve, në pajtim me Nenin 19;
- b.** deklarojnë qartë në kodet e sjelljes parimin e përgjegjësisë civile të nëpunësve publikë, si dhe të rritin ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me të, si për shembull gjatë trajnimeve përkatëse;

- c. monitorojnë progresin në këtë fushë duke mbajtur të dhëna për numrin e padive civile dhe rezultatin e tyre.

GREVIO fton më tej autoritetet të vlerësojnë se cilat janë arsyet mbizotëruese që pengojnë viktimat të kenë qasje në mjetet juridike civile kundër autoriteteve shtetërore dhe, mbi bazën e këtyre gjetjeve, të marrin masa për të trajtuar shkaqet. Këto masa mund të jenë, për shembull, ngritja e një sistemi specifik që i mundëson përdoruesit e gjykatave të marrin kompensim pas mosfunksionimit të sistemit gjyqësor që i ka dëmtuar (paragrafi 114)

Rekomandimi 32

(Kapitulli 5/A, Neni 31/3 – Kujdestaria dhe të drejtat e vizitave)

GREVIO i nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet:

- a. të sigurojnë që, në çdo rast, përcaktimi të mënyrave të ushtrimit të të drejtave të kujdestarisë dhe të vizitave të jenë në përputhje me kërkesat e nenit 31. Për këtë qëllim, autoritetet duhet:
 - b. të pyesin kryesisht nëse, në rast të një kërkesë për urdhër mbrojtje të një viktime të dhunës në familje përfshihen fëmijë, si dhe të shqyrtojnë nëse edhe për ta duhet të lëshohet një urdhër mbrojtje;
 - c. në kuadër të çdo vendimi për të lëshuar një urdhër mbrojtje ose një vendim tjetër gjyqësor që vendos për çështje familjare ku ka pasur/ ka dhunë (si për shembull, në rastet e ndarjes ose divorcit), të bëjnë përcaktimet e duhura në lidhje me të drejtat e kujdestarisë dhe të vizitave, duke i kushtuar rëndësi të veçantë dhunës dhe interesit më të lartë të fëmijës, sipas një vlerësimi rast pas rasti;
 - d. të korrigjojnë çdo boshllëk që mund të ketë në ligj për zgjidhjen e të drejtave të kujdestarisë dhe të vizitave, gjatë çdo procesi gjyqësor, siç është rasti i apelit kundër vendimit për divorc;
 - e. të sigurojnë që zbatimi i urdhrave për pasjen e kontaktit nuk i ekspozon viktimat dhe fëmijët e tyre ndaj një rreziku të mëtejshëm;
 - f. të monitorojnë praktikën e gjykatave në këtë fushë dhe të matin progresin (paragrafi 121)

Rekomandimi 34

(Neni 36 – Dhuna seksuale përfshirë përdhunimin)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet të:

- a. ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit të grave të rritura në mënyrë që të bazohet në mungesën e lirisë së dhënies së pëlqimit dhe të mos kërkojë demonstrim të përdorimit të forcës apo rezistencës;
- b. ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit që përfshin fëmijët ndërmjet moshës 14 dhe 18 vjeçare, në mënyrë që të bazohet në mungesën e një pëlqimi të dhënë lirisht dhe të mos kërkojë demonstrim të përdorimit të forcës ose rezistencës. Në vlerësimin e pëlqimit të plotë dhe të lirë të fëmijës, konsideratë e duhur

- duhet t'i kushtohet hendekut të moshës ndërmjet përdhunuesit dhe viktimës;
- c. ndryshojnë përkufizimin e përdhunimit që përfshin fëmijët ndërmjet moshës 14 dhe 18 vjeçare, në mënyrë që të mos varet nëse viktima ka arritur apo jo moshën e pjekurisë;
 - d. kriminalizojnë sjelljen seksuale pa dhënien e pëlqimit, të përshkruar në paragrafin 1, germa b dhe c të nenit 36 të Konventës;
 - e. miratojnë masat e nevojshme për të siguruar që çdo krim i dhunës seksuale ndiqet dhe zbatohet ndërmjet ish-bashkëshortëve ose bashkëshortëve aktualë, ose partnerëve, siç njihen nga ligji i brendshëm (paragrafi 139)

Rekomandimi 43

(Kapitulli V/B, pika 10, Neni 48/b Pajtimi në procedurat civile)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet të marrin masat e nevojshme, duke përfshirë ndryshimin në legjislati përkatës, për të:

- a. përjashtuar qartësisht zbatueshmërinë e procedurës së pajtimit gjatë rrjedhës së procedurës për lëshimin e urdhrave të mbrojtjes;
- b. vendosur parimin se pajtimi nuk mund të jetë i detyrueshëm në procedurat e divorcit, ku ka dhunë;
- c. përfshirë një vlerësim të rrezikut dhe të masave mbrojtëse për të siguruar pëlqimin e plotë dhe të lirë të viktimës në kuadër të çfarëdo procedure të pajtimit vullnetar (paragrafi 175)

Rekomandimi 45

(Kapitulli VI/B, Neni 51 – Vlerësimi i riskut dhe menaxhimi i riskut)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet të zhvillojnë procedura të standardizuara për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut të vdekshmërisë dhe dhunës së përsëritur për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave të mbuluara nga Konventa, dhe të ofrojnë trajnime në përputhje me to. Këto procedura duhet të kthehen në kryesore për reagimin e koordinuar shumë-sektorial të mekanizmave të referimit në Shqipëri dhe të vihen në dispozicion të të gjithë profesionistëve që hyjnë në kontakt me viktimat (paragrafi 182)

Rekomandimet 46 dhe 47

(Kapitulli VI/C, Neni 52 dhe 53 – Urdhrat e jashtëzakonshëm dhe urdhrat mbrojtës)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet të:

- a. rishikojnë dispozitat ligjore të UMM-ve për të siguruar që në situata të një rreziku të menjëhershëm, UMM-të të lëshohen pa vonesa të panevojshme për të garantuar sigurinë e viktimës;
- b. pa cenuar nevojën për siguri të menjëhershme të viktimave, të integrojnë, në procedurën e lëshimit të urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrat të mbrojtjes, vlerësimin e rrezikut;
- c. promovojnë një rol më aktiv të agjencive të zbatimit të ligjit, prokurorisë dhe

gjykatave, duke i nxitur ato të shfrytëzojnë të drejtat e tyre teksa respektojnë zgjedhjet e informuara të viktimave;

- d. sigurojnë ekzekutimin efektiv të urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrave të mbrojtjes nga ana e agjencive përgjegjëse, në veçanti përmbaruesve;
- e. ndjekin penalisht dhunuesit që shkelin urdhrat e mbrojtjes së menjëhershme dhe urdhrat e mbrojtjes, si dhe të zbatojnë dënimet penale përkatëse;
- f. nxjerrin para përgjegjësisë nëpunësit që nuk zbatojnë urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes dhe urdhrat e mbrojtjes, duke zbatuar dënimet penale përkatëse;
- g. identifikojnë fushat e mëtejshme ku ka vend për përmirësim duke analizuar arsyet e numrit të lartë të viktimave që kërkojnë mbrojtje me anë të mekanizmit të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes/urdhrit të mbrojtjes (paragrafi 188)

Duke marrë parasysh kërkesën e nenit 53 që urdhrat e kufizimit ose të mbrojtjes të vihen në dispozicion të viktimave të të gjitha formave të dhunës që mbulon Konventa, GREVIO I nxit më tej (kërkon më tej sa më parë nga) autoritetet të paraqesin forma të tjera të mbrojtjes së viktimave të dhunës ndaj grave, përveç dhunës në familje (paragrafi 189)

Rekomandimi 48

(Kapitulli VI/C, Neni 52 dhe 53 – Urdhrat e jashtëzakonshëm dhe urdhrat mbrojtës)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet që, në bashkëpunim të ngushtë me Urdhrin e Psikologëve, të marrin masat e nevojshme për të siguruar që:

- a. në të gjitha rastet kur lëshohet një urdhër mbrojtje për viktimat e dhunës në familje, gjendja e të miturve dëshmitarë të shqyrtohet sistematikisht, pavarësisht nga kërkesa specifike e kërkuarit, për të përcaktuar nëse duhet edhe ata të përfitojnë nga urdhri i mbrojtjes;
- b. raportet psikologjike të paraqitura para gjykatave t'i përgjigjen kriterëve të kërkuara të profesionalizmit dhe objektivitetit;
- c. tarifat e raportit të detyrueshëm psikologjik të mos përbëjnë pengesë për të pasur qasje në drejtësi (paragrafi 191)

Rekomandimi 49

(Kapitulli VI/D, Neni 52 paragrafi 1 – Procedimet Ex parte and ex officio)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet që të amendojnë dhe sjellin legjislacionin shqiptar në përputhje me rregullat në lidhje me ndjekjen ex parte dhe ex officio të përcaktuara në nenin 55, paragrafi 1 të Konventës (paragrafi 198)

Rekomandimi 51

(Kapitulli VI/F, Neni 57 – Ndihma ligjore)

GREVIO nxit (kërkon sa më parë nga) autoritetet që të marrin masat e nevojshme legjislative dhe masa të tjera për të:

SUGJERIME:

Për të hartuar raportin në lidhje me procedurën follow-up pas vlerësimit të parë të GREVIO për Shqipërinë:

1. Raporti shpjegues i Konventës ndihmon për të kuptuar se si e trajton Konventa konceptin e dhunës ndaj grave dhe çfarë detyrimesh kanë shtetet në bazë të Konventës;
2. Përcaktoni prioritetet që ka institucioni në lidhje me adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore/ Zgjidhni ato nënë të konventës mbi të cilat institucioni mendon të raportojë;
3. Përfundimet e vlerësimit të parë të GREVIO për Shqipërinë ju ndihmojnë për çështjet që institucioni i ka prioritet te punës së tij;
4. Mblidhni të dhëna që mbështesin argumentet tuaja dhe koordinoni punën me aktorë të tjerë që mbrojnë të drejtat e njeriut apo viktimat e dhunës kundër grave, përfshirë dhunën në familje;
5. Kërkoni informacion nga autoritetet qeveritare në lidhje me masat që janë duke marrë për zbatimin e rekomandimeve të GREVIO-s.
6. Hartoni një plan tuajin masash për adresimin e zgjidhjeve dhe loboni me autoritet qeveritare për t'i marrë ato parasysh;
7. Hartoni raportin tuaj në lidhje me masat e marra nga ana e shtetit dhe përgatisni një përmbledhje të tij për ta bërë publike dhe për ta promovuar në media, rrjete sociale etj.

- a. krijuar dhe financuar në mënyrë adekuate një sistem efektiv të ndihmës juridike për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave të mbuluara nga Konventa, bazuar edhe në përfshirjen e avokatëve të trajnuar në mënyrë adekuate;
- b. siguruar që viktimat të informohen siç duhet për të drejtën e tyre për të pasur akses në ndihmë juridike;
- c. njohur, mbështetur dhe promovuar punën e OJF-ve të specializuara në prokurimin e ndihmës juridike për viktimat (paragrafi 206).

III. Mekanizmi UPR

3.1. Monitorimi i zbatimit të Rekomandimeve të UPR mbi barazinë gjinore dhe dhunën kundër grave 2014;

3.2. Informacion me shkrim/ përgatitja e raportit nga institucioni i Avokatit të Popullit.

Hyrje

Rishikimi Periodik Universal u krijua si një proces i Këshillit të të drejtave të Njeriut. Procesi rishikon situatën e të drejtave të njeriut në secilin prej 193 shteteve të Kombeve të Bashkuara çdo 4.5 vjet³³. Angazhimi i institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut dhe shoqërisë civile është me shumë rëndësi gjatë këtij procesi. Përmes angazhimit në UPR institucioni i AP ka mundësi:

- Të ngrejë shqetësimet e veta në lidhje me çështje specifike të të drejtave të njeriut
- Të influencojë në nxjerrin e rekomandimeve nga Grupi i Punës në fund të procesit të rishikimit për të përmirësuar gjendjen e të drejtave të njeriut në vendin e tyre.
- Të ndihmojë në përmbushjen e rekomandimeve nga ana e Shtetit.


Kjo pjesë e Manualit paraqet një prezantim të shkurtër të procesit të rishikimit dhe përmban rekomandime dhe sugjerime me qëllim që përfshirja në procesin e rishikimit të jetë sa më e suksesshme.

Çfarë është UPR?

Rishikimi Periodik Universal (UPR) është një mekanizëm i ri për të drejtat e njeriut i Këshillit të të Drejtave të Njeriut (KDN) i krijuar në 15 Mars 2006 nga rezoluta 60/251 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Përmes këtij mekanizmi rishikohet plotësimi i detyrimeve të 193 shteteve anëtare të OKB në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si edhe progresi, sfidat dhe nevojat për përmirësim në mënyrë që të garantohen efektivisht korpusi i të drejtave të njeriut i njohur nga instrumentet ndërkombëtare. Shtetet monitorohen dhe kalojnë në procesin e rishikimit çdo 4.5

³³ Human Rights Project "A practical guide to the United Nations' Universal Periodic Review", fq 5, 2010

vjet. UPR është dizenuar për t'u aplikuar universalisht dhe në uniformitet për të gjitha shtetet. UPR është një mekanizëm inovativ dhe bashkëpunues që bazohet në modelin e dialogimit midis shtetit që është në rishikim dhe çdo shteti tjetër të OKB. Procesi zgjat 3 ½ orë. Gjatë fazës së dialogut ndëraktiv, shteti paraqit raportin e tij, i përgjigjet pyetjeve dhe merr rekomandime nga çdo shtet tjetër.(90 minuta). Procesi lehtësohet nga një grup prej tre raportuesish të quajtur Trojka të cilët përgatisin listën e çështjeve dhe pyetjet për shtetin në proces rishikimi bazuar në informacionin e dërguar nga shtetet e tjera. Pyetjet i jepen Shtetit dhe qarkullohen në Grupin e Punës të paktën 10 ditë përpara rishikimit. Pas dialogut, Trojka përgatit një raport të Grupit të Punës me Shtetin nën rishikim dhe me asistencën e Sekretariatit Këshillit, i cili përmban një përmbledhje të plotë të procesit. Rishikimi përfundon me një dokument i cili përmban të gjitha rekomandimet që ia janë bërë shtetit në proces rishikimi i cili miratohet zyrtarisht në sesionin pasues të Këshillit të të Drejtave të Njeriut.



Kur u krijua UPR?

Në vitin 2006, u krijua UPR në kuadrin e Këshillit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara, me qëllim adresimin e boshllëqeve në infrastrukturën e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara për të plotësuar punën e të dyjave mekanizmave të konventave dhe sistemeve të Procedurave të veçanta.

Cili është mekanizmi që kryen rishikimin e të drejtave të njeriut të shteteve?

Grupi i punës së UPR është mekanizmi që kryen rishikimin e të drejtave të njeriut të shteteve.

Grupi i punës takohet në Gjenevë, Zvicër tre herë në vit me një total të 14 vendeve për çdo sesion për tu rishikuar. Sesionet e grupit të punës zakonisht kryhen në Janar, Maj dhe Nëntor.

• Cilat janë instrumentet objekt rishikimi?

Institucioni i AP duhet që paraprakisht të njihet me listën e dokumenteve që janë objekt i rishikimit gjatë UPR. Kështu, gjatë procesit UPR, çdo shtet rishikohet në lidhje me zbatueshmërinë e instrumenteve ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut që konsistojnë në:

1. Karta e Kombeve të Bashkuara
2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
3. Instrumentet e të drejtave të njeriut, traktate, konventa të ratifikuara nga Shteti që Rishikohet.
4. Zotimet që ka marrë Shteti përsipër, përfshirë ato që ka marrë kur paraqet kandidaturën për zgjedhjen në Këshillin e të Drejtave të Njeriut;
5. E drejta humanitare e aplikueshme.³⁴

Cilat janë tre dokumentet mbi të cilat mbështetet shqyrtimi UPR?

1. Raporti Kombëtar i shtetit nën shqyrtim shpjegon arritjet dhe sfidat në zbatimin e rekomandimeve që nga rishikimi i fundit (10,700 fjalë). Ky raport bazohet në konsultime të gjera në nivel kombëtar me aktorë të ndryshëm, në të cilin roli i institucionit të AP është i një rëndësie të veçantë;
2. Përpilimi i informacionit të Kombeve të Bashkuara. Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut përpilon informacionin që merr nga agjencitë e ndryshme të Kombeve të Bashkuara, procedurat e veçanta dhe mekanizmat e konventave rreth zhvillimeve në situatën e të drejtave të njeriut në shtetin nën shqyrtim që nga cikli i mëparshëm (5,350 fjalë)
3. Përmbledhje nga aktorët. Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut përmbledh raportet e paraqitura nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe organizatat jofitimprurëse, mbi situatën e të drejtave të njeriut në shtetin nën shqyrtim (5,350 fjalë).

A mund të paraqesë raporte me shkrim institucioni i Avokatit të Popullit në kuadrin e këtij shqyrtimi?

Po, institucioni i Avokatit të Popullit mund të paraqesë raport/informacion me shkrim në kuadrin e këtij shqyrtimi.

A mundet që institucioni i Avokatit të Popullit të propozojë rekomandime në këtë procedurë?

Po, institucioni i Avokatit të Popullit mund ti propozojë draft rekomandime shteteve rekomanduese të Grupit të Punës së UPR.

³⁴ Dokumentet objekt rishikimi janë parashikuar nga Rezoluta 5/1 e Këshillit të të Drejtave të Njeriut miratuar në 18 qershor 2008, në paragrafin 1 të Aneksit të saj, të cilën mund ta konsultoni tek <http://www.ohchr.org/EN/HRBodies/UPR/Pages/BasicFacts.aspx>

A mund të marrin fjalën përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit në këtë proces shqyrtimi/rishikimi?

Po, në 18 Shtator 2014, në sesionin e 27 të Këshillit të Drejtave të Njeriut të OKB-së, në kuadër të Rishikimit Periodik Universal, Avokati i Popullit Igli Totozani mbajti fjalën pranë Këshillit nëpërmjet një videomesazhi në lidhje me situatën e të drejtave të Njeriut në Shqipëri³⁵.

Cilat ishin disa nga shqetësimet e ngritura nga institucioni i AP në vitin 2014 në kuadrin e Rishikimit Periodik Universal?

- Harmonizimi i legjislacionit kombëtar më atë ndërkombëtar dhe veçanërisht zbatimi i tij,
- rritja e kapaciteteve dhe pavarësisë së institucioneve të pavarura, përfshi këtu edhe Avokatin e Popullit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit;

Më në veçanti, disa drejtime të punës së institucionit ishin:

- Forcimi i mëtejshëm i sistemit të mbrojtjes sociale, me qëllim parandalimin e shfrytëzimit të punës së të miturve dhe luftimit të shkaqeve të shfaqjes së këtij fenomeni;
- Nevoja e një ligji për minoritetet;
- Qasje proaktive për të luftuar shkaqet e fenomenit të gjakmarrjes.
- Çështje si afati i kompensimit të persekutuarve nga regjimi komunist, hapja e arkivave/dosjeve të komunizmit, si dhe gjetja e personave të zhdukur gjate asaj periudhe.
- Konsolidimi i mekanizmave kundër dhunës në familje. Nevoja për përmirësimin e koordinimit ndërmjet institucioneve qendrore dhe atyre lokale;
- Probleme të infrastrukturës dhe mbipopullimit dhe problemet që sjellin në integrimin social të të dënuarve. Nevoja për zgjidhjen e problemit të personave për të cilët gjykatat kanë urdhëruar shtrimin në spital psikiatrik, por që vazhdojnë të mbahen akoma në spitalet e burgjeve.
- Gjendja juridike e pronës private, duke përfshirë edhe zgjatjen e proceseve gjyqësore, si dhe moszbatimin e vendimeve të gjykatave.
- Situata ekonomike që kalon vendi nuk duhet të lejojë uljen e standardeve të arritura ndaj personave me aftësi të kufizuara. Përfaqësimi i personave me aftësi të kufizuara;
- Zbatimi i legjislacionit në lidhje me të drejtat e personave LGBT;
- Korrupsioni dhe nevoja për masa të veçanta dhe specifike³⁶.

35 <http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/content/18092014-fjala-e-avokatit-t%C3%AB-popullit-n%C3%AB-k%C3%ABshillin-e-t%C3%AB-drejtave-t%C3%AB-njeriut-gjener%C3%AB>

36 <http://www.avokatipopullit.gov.al/sq/content/18092014-fjala-e-avokatit-t%C3%AB-popullit-n%C3%AB-k%C3%ABshillin-e-t%C3%AB-drejtave-t%C3%AB-njeriut-gjener%C3%AB>

A mund të luajë rol institucioni i Avokatit të Popullit në kohën nga publikimi i raportit të Grupit të Punës deri në miratimin e raportit nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut?

Në periudhën nga publikimi i raportit të Grupit të Punës deri në miratimin e raportit nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit lobon me qëllim që rekomandimet të mbështeten nga qeveria e shtetit në shqyrtim/rishikim.

Ku konsiston roli i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë procedurë?

Së pari , lehtëson dialogun midis qeverive dhe shoqërisë civile;

Së dyti, mbështet të gjithë aktorët në zbatimin e rekomandimeve;

Së treti, punon për monitorimin e progresit; Disa nga shqetësimet e identifikuara nga institucioni i Avokatit të Popullit mund të bashkohen me ato të organizatave jofitimprurëse duke krijuar mundësinë për koalicion;

Së katërti, punon për raportimin e progresit në kuadrin e UPR;

Ku konsiston roli i institucionit të Avokatit të Popullit gjatë përgatitjes së raportit kombëtar?

Së pari, institucioni i AP ofron inputet e vetë institucionit dhe lehtëson komunikimin midis qeverisë dhe shoqërisë civile;

Së dyti, institucioni i AP siguron përfaqësimin e perspektivës së grupeve të marginalizuara;

A përbën një mundësi për institucionin e AP raportimi i ndërmjetëm i shtetit?

Raportimi i ndërmjetëm është një mundësi për bashkëpunimin e institucionit të Avokatit të Popullit për të bashkëpunuar me shtetin për zbatimin e UPR. Është një mundësi për të përfshirë në këtë raport inpute të institucionit të Avokatit të Popullit.

ANEKS

Pyetësi mbi masat legjislative dhe masa të tjera sipas dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave e dhunës në familje

(Konventa e Stambollit)

POLITIKAT E PËRFSHIRA DHE TË DHËNAT E MBLEDHURA

(KREU II I KONVENTËS, NENET 7 -11)

Ju lutemi të jepni informacion mbi miratimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe koordinuara mbi dhunën kundër grave, burimet financiare të dedikuara për zbatimin e këtyre politikave, dhe mbështetja e punës së OJQ-ve dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile, në veçanti organizatat e grave, krijimi i efektiv bashkëpunimi me këto organizata, si dhe mbledhjen e të dhënave.

A. Ju lutemi jepni detajet e planit / strategjive të veprimit (a) dhe çdo politikave të tjera përkatëse të miratuara nga autoritetet tuaja për të adresuar dhunën ndaj grave, siç përmendet në nenin 7. Ju lutem, përshkruani në mënyrë të veçantë:

1. cilat forma të dhunës janë të mbuluara;
2. afati (s);
3. cilat të drejta njerëzore të viktimave janë vendosur në qendër të këtyre politikave;
4. se si politikat janë të bashkërenduara për të ofruar një përgjigje efektive holistike dhe gjithëpërfshirëse;
5. masat e marra për zbatimin e tyre në nivel rajonal / vendor;
6. Progresi i bërë në zbatimin e tyre.

